Sistemet e përbëra nga ekuacionet themelore diferenciale të hidro-dinamikës së fluideve dhe nga ekuacionet plotësuese do të zgjidhen sipas metodave numerike. Nga ky shkak, kemi përshkruar metodat e mundshme numerike të zgjidhjeve, për rrjedhjen e qëndrueshme dhe të paqëndrueshme. Ndër këto mund të përmenden: ajo e karakteristikave, e diferencave të fundme, e linearizimit, e transformimit të variabëlve si dhe ato hibride.

Në këtë kapitull, do të analizohet aplikimi i metodës së Hardy-Cross-it për llogaritjen e prurjes të qëndrueshëm dhe metodës së karakteristikave për rrymimin e paqëndrueshëm të fluideve. Më poshtë, do të përshkruhen kriteret për stabilitetin numerik si dhe përkufizimi i kushteve kufitare për aplikimin e metodave në fjalë. Përshkrimi matematikor-numerik paraqet bazën e hartimit të algoritmeve për programet kompjuterike të llogaritjeve hidraulike për sistemet e thjeshta dhe komplekse të rrjetave me tubacione.

6.1. Përdorimi i metodave numerike për rrjedhjen stacionar të fluidit

Rrjedhjet reale të fluideve ndodhin në hapësirë, prandaj studimi matematik i tyre bëhet në hapësirë. Megjithatë, nga fakti se, këto procese përshkruhen me ekuacione diferenciale të pjesshme jo lineare, zgjidhjet e përgjithshme të tyre nuk janë të sakta për çdo kusht kufitar. Zgjedhja e tyre arrihet vetëm nëse ekuacionet thjeshtohen dukshëm. Për këtë arsye, metodat numerike përdoren sidomos për problemet tek të cilat nuk gjenden zgjidhje analitike.

Më poshtë jepet një pasqyrë e shkurtër e metodave më të suksesshme numerike që përdoren në dinamikën e fluideve. Gjatë rrjedhjes të fluideve në sistemet gypore, një numër i madh i modeleve hidraulike që përshkruajnë ato, mund të zgjidhen mjaft saktësisht me përdorimin e analizës një permasore, kushtet për përdorimin e së cilës janë përshkruar në kapitullin paraprakë. Kjo analizë, siç dihet, bazohet në supozimin se të gjitha madhësitë janë në varësi vetëm prej koordinatës gjatësore në drejtim të rrjedhjes të fluidit dhe prej kohës. Për shkak të jo linearitetit të ekuacioneve diferenciale, zgjidhja e tyre realizohet në mënyrë iterative, domethënë nëpërmjet përafrimit të njëpasnjëshëm. Pos metodave numerike, ekzistojnë edhe metodat grafike, por që, me paraqitjen e kompjuterëve, kanë humbur rëndësinë e tyre. Përkundrajt karakteristikave themelore të tij, rrymimi mund të jetë stacionar ose jo stacionar

dhe me fluid jo të ngjeshëm (jo të shtypshëm) ose ngjeshëm (shtypshëm), dhe mbi këtë bazë janë zhvilluar edhe metodat numerike përkatëse.

Në kapitullin e mëparshëm janë nxjerrë ekuacionet e vazhdueshmërisë dhe të sasisë së lëvizjes, të cilat krahas atij, përbëjnë një model të rrjedhjes jo stacionar e njëpërmasor të fluidit me ngjeshmëri të dobët në gyp përcjellësin elastik. Këto shprehje formojnë sistemin prej dy ekuacionesh diferencialë parciais jo lineare e jo homogjenë të rendit të parë të llojit hiperbolik, për zgjidhjen e të cilave më e përshtatshme është metoda e karakteristikave.

Për zgjidhjen (integrimit) e sistemit të ekuacioneve diferenciale të rrjedhjes stacionar të fluidit që lëviz në rrjetat me tubacione, më e njohur është metoda e Hardy – Crossit. Radha iterative e saj është:

- shpërndarja e prurjes supozohet se kënaq ekuacionin e vazhdimësisë në çdo nyje;
- për prurjet e supozuara llogariten rëniet (humbjet) e presionit në çdo element të sistemit dhe bëhet korrigjimi i tyre në çdo qark elementar;
- me vlerat e llogaritura të rënies së presionit dhe të korrigjimeve të prurjes bëhet edhe korrigjimi në çdo nyje.

Ekzistojnë edhe metoda tjera, që, parimisht, mbështeten në atë të Hardy–Crossit, si për shembull metoda e simulimit të drejtpërdrejtë, metodat e Lax-Wendroff-it, Ameins-is, Liggett – Woolhiserit, etj. Në paragrafin të këtij kapitulli kemi përpunuar përdorimin e metodës së Hardy-Crossit gjatë rrjedhjes të fluidit jo të shtypshëm në rrjetat e ndërlikuara gypore, duke dhënë, gjithashtu, edhe algoritmin adekuat për përdorimin e tij në kompjuter.

6.2. Metodatat numerike për gjendjen jo stacionare te rrjedhjes te fluidit

6.2.1. Metoda e karakteristikave

Për llogaritjen e rrjedhjes jo stacionar të fluidit nëpër rrjetat e tubacioneve është përdorur metoda e karakteristikave, si një nga të parat e njohur për këtë qëllim. Kjo metodë karakterizohet nga thjeshtësia shumë e madhe matematikore (d.m.th. e programimit), nga qartësia e saj si dhe nga lehtësia e përdorimit të kompjuterit. Veçori e rëndësishme është se ajo jep rezultate të përputhura shumë mirë si me të dhënat eksperimentale (matjet) ashtu edhe referuar ndërrimeve të shpejta dhe ekstreme të kushteve kufitare. Por, duhet theksuar se, metoda e karakteristikave është numerikisht e qëndrueshme vetëm kur ndryshimi kohor Δt dhe

hapësira i integrimi Δx plotëson kriterin e Lewy-Couranta. Metoda e karakteristikave përdoret atëherë kur problemi fizik, d.m.th. modeli hidrodinamik është përshkruar me ekuacionet parcialet diferenciale të llojit hiperbolik. Në dinamikën e fluideve, kjo metodë është posaçërisht e përshtatshme për dy variabla të pavarura, d.m.th., për studimin e rrjedhjes stacionare dypërmasore për shpejtësi mbi atë të zërit dhe të rrjedhjes jo stacionare një dimensionale.

6.2.2. Metoda e diferencave të fundme

Thelbi e kësaj metode qëndron në faktin se, diskretizimi i variabëlve të pavarura të ekuacioneve diferenciale të pjesshme, që përshkruajnë rrjedhjen e fluidit, bëhet në rrjetin katër këndor hapësinor dhe kohor. Kështu, për shembull, vlerat e presioneve dhe të prurjeve në nyjet e rrjetës shfrytëzohen për përafrimin e komponentëve në ekuacionet diferenciale të modelit hidrodinamik. Me vlerat e njohura të kushteve të skajshme (kufitare), nga ekuacioni diskretizues, caktohen presionet e rrjedhës në momentin e ardhshëm kohor. Ky proces zhvillohet derisa të përcaktohen presionet dhe prurjet në tërë intervalin kohor për të cilin janë dhënë kushtet kufitare (koha e integrimi).

Metoda e diferencave të fundme mund të jetë:

- Eksplite, tek e cila për çdo madhësi të panjohur, në një moment të çfarëdoshëm kohor, mund të jepet një shprehje e varur nga madhësitë e përcaktuara prej momentit paraardhës. Në këto kushte, sistemi i ekuacioneve nuk ka nevojë të zgjidhet.
- Implicite, tek e cila mënyra e zgjedhur e diskretizimit të ekuacioneve të modelit hidrodinamik çon deri tek sistemi i ekuacioneve që duhet të zgjidhet në mënyrë simulative. Vetë e mirë e metodave implicite është stabiliteti i pakushtë. Kjo do të thotë se, me saktësi të kënaqshme, mund të shfrytëzohen edhe hapat e integritit, dukshëm më të gjatë ndaj kohës dhe se, faktori që kufizon gjatësinë e hapit kohor të integritit nuk është metoda por shpejtësia e ndërrimeve të kushteve kufitare. E meta e metodave implicite qëndron në faktin se, në çdo hap kohor duhet të zgjidhet sistemi i ekuacioneve jo lineare. Njëra ndër këto metoda është ajo e Crank-Vicolsonit. Ka edhe të tjera, të ngjashme, e të zhvilluara nga autorë të ndryshëm: Tuppeck-Kirsche, Di StefaNr, Gay-Wylie, Galerkin.

Metodat e përmendura më sipër janë zhvilluar për rrjedhjen njëpërmasore. Për rrjedhjen dy dhe trepërmasore, me vlera të vogla të numrit të Mach-it, shumë e suksesshme është metoda e Prandtl-Glauert-it.

6.2.3. Metoda e linearizimit

Kjo metodë bazohet në linearizimin e ekuacioneve diferenciale para se të fillohet me zgjidhjen e tyre. Këtë herë fitohen ekuacione diferenciale te pjesshme lineare të cilat në shumicën e të rasteve mund të zgjidhen me sukses. Metoda është mjaft e përshtatshme për rrjedhjen e fluidit rreth trupave të fortë e të hollë, kur ndryshimi i shpejtësive është shumë i vogël përkundrejt shpejtësisë së rrymës të pa çrregulluar. Ajo nuk është e përshtatshme për studimin e rrymimeve në kushtet kalimtare të rrjedhjes.

6.2.4. Metoda e transformimit te variablave

Me këtë metodë, ekuacionet diferenciale jo lineare shndërrohen në lineare. Kështu në ekuacionet e mësipërme ndërron roli i variablave të varura dhe të pavarura. Metoda mund të përdoret për rrjedhjen dypërmasor stacionar, me ç ‘rast problemi transformohet nga rrafshi $x - y$ në atë $u - v$, ku x dhe y janë pozicionet e koordinatave; ndërsa u dhe v komponentët e shpejtësive në drejtimin x dhe y . Ky transformim quhet hodografik. Në literaturë, metoda e transformimit të variablave, ndonjëherë, njihet edhe si metoda e Hodografit.

6.2.5. Metoda e variacioneve

Disa trajta të rrjedhjes, për fluidin e ngjeshëm, mund të zgjidhen me përdorimin e llogaritjes variabile, me ç ‘rast ekuacioni jo linear diferencial trans-formohet në integral variabël.

6.2.6. Metoda hibride

Pos çka cekëm deri tani, gjithnjë e më shpesh, hasim edhe metodat e ashtuquajtura hibride. Ato paraqesin kombinimin e dy ose më shumë metodave paraardhëse. Posaçërisht i suksesshëm është treguar kombinimi metodës së karakteristikave me atë të diferencave të fundme.

Ekzistojnë edhe metoda të tjera që bazohen në analogjinë e dukurive fizike, si për shembull në analogjinë në mes të fenomeneve elektrike dhe hidraulike. Në këtë mënyrë është zhvilluar edhe metoda e fenomeneve për rrjedhjen jo stacionar të fluideve të pangjeshëm.

KAPITULLI VII

7. PROJEKTI FINAL

Kapitulli në vijim ofron informata specifike mbi projektimi përfundimtar të sistemeve të transportit të ujit dhe punëve për mbrojtje të kanalit të Ibër-Lepencit dhe masave specifike që do të zbatohen përmes Projektit.

7.1 Përmbledhje e Sistemit të Transportit të Ujërave

Elementet kryesore të sistemit të transportit të ujit të cilat janë përfshirë në Komponentin nr. 1 janë si vijon:

- Marrja e ujit nga kanali Ibër-Lepencit në Mihaliq;
- Tubacioni i ujit të pijshëm me gravitetit DN1200 nga Mihaliqi në stacionin e pompimit në Milloshevë;
- Stacioni i Pompave Milloshevë;
- Linja e energjisë elektrike me stacionin e pompimit të Milloshevës;
- Tubacioni kryesor i Ujit te papërpunuar nga stacioni i pompimit të Milloshevës në FPU Shkabaj;
- Gypi i pompimi te ujit të pijshëm nga FPU Shkabaj në rezervuarin ekzistues të Arbërisë;
- Tubacioni i pompimi te ujit të pijshëm nga FPU Shkabaj në rezervuarin ekzistues Shkabaj;
- Tubacioni me gravitet i ujit nga FPU Shkabaj për lidhje me tubacionin ekzistues DN500 që çon ujin nga rezervuari Shkabaj për në Obiliq DN500;
- Kabllot optike që lidhin SP-në e Milloshevës, FPU-në e Shkabaj, rezervuarët e Shkabaj dhe të Arbërisë, dhe
- Sistemi automatik i kontrollit (zbatuar përmes Komponentit Nr. 1).

7.2 Vepra e marrjës se ujit të papërpunuar ne Mihaliq

Marrja e ujit të papërpunuar përbëhet nga një dhomë e marrjes së bashkangjitur në strukturën ekzistuese të degëzimit në Mihaliq. Dhoma do të jetë e pajisur me një valvole të mbyllur dhe

rrjetat të pastruara në mënyrë automatike. Për më tepër, do të instalohet një modul i pajisjeve testuese për të monitoruar dhe analizuar cilësinë e ujit të papërpunuar. Sasia prej 700 l/s për fazën 1 dhe 550 l/ss, totali faza I dhe Faza II -1250 l/s përfaqësojnë ujin e trajtuar jo ujin e papërpunuar. Prandaj, midis 5-10% më shumë ujë do të duhet të hiqet. Sasia mesatar e llogaritur është rreth 1,042 l/s.

Struktura e veprës marrëse përbëhet nga dy kanale secili me rrjeta (ekran) të trashë dhe të hollë. Çdo kanal do të pajiset me një portë (penstock) për të mundësuar mbylljen e saj. Llogaritjet hidraulike janë bërë për ekranet e trashë, dhomën e sedimentimit dhe ekranet e imëta. Rrjetat (Ekranet) e trashë dhe rrjetat (Ekranet) e imët janë të permasuar për një rrjedhë prej 687.5 l / s. Dhoma e sedimentimit është projektuar për të vendosur rrjeta me vrima mbi 1.5 mm madhësi.

7.3 Llogaritja e sasisë se Ujit

Pas një diskutim të prodhimit nga FPU për Fazën 1 dhe Fazën 2. Vlerat e 700 l/s për Fazën 1 dhe 1,250 l/s për Fazën 2 përfaqësojnë ujin e trajtuar jo ujin e papërpunuar. Prandaj, nga 5 deri në 10 për qind më shumë ujë do të duhet të hiqet nga kanali i Ibër- Lepecit për të lejuar furnizimin të mjaftueshëm, përdorimin e ujit në FPU etj.

Marrëveshja e marrjes së ujit duhet të kontrollohet në detaje, megjithatë 1,250 l / s përfaqëson prodhimin maksimal, me llogaritjet mesatar me kalimin e kohës përafërsisht. 80 për qind e 1,250 l / s. Nëse marrëveshja për nxjerrjen e ujit lejon 1,250 l / s, llogaritjet mesatar me kalimin e kohës do të ishte 1,042 l / s, gjegjësisht 1.250 / 1.2. Shtimi i 10 për qind në këtë shifër do të jepte 1,146 l / s që do të ishte ende nën sasinë e 1,250 l / s.

Për permasimin e tubacioneve të transportit të ujit të papërpunuar me graviteti ashtu edhe pompimi, prurja maksimale e kërkesës maksimale ditore për Fazën 2 prej 1,375 l / s.

7.4 Tubacionet - Të përgjithshme

7.4.1 Shtrirja e tubave

KURP konfirmon se trasat e shtrirjes së tubave të transportit të ujit nuk ka pengesa nga ndërtesat në trasenë e planifikuar për shtrirjen e tubacionit. Edhe pse gjatë realizimit të këtij projekti ka pas probleme por në fund janë tejkaluar me ndihmën e Qeverisë dhe popullatës.

7.4.2 Kapaciteti i tubacionit

Kapaciteti i fazës së parë të FPU është 700 l/s, faza e dytë është rritja e kësaj me 550 l/s. Tubacioni i transportit të ujit të papërpunuar është projektuar për 1250 l/s, kërkesa për fazën 2. Kjo do të merret nga struktura e marrjes Mihaliq në Kanalin Ibër Lepecit për në stacionin e pompimit të Milloshevës dhe gjithashtu nga ky stacion i pompimit do të transportohet në FPU në Shkabaj. Diametri i tubacionit për këto dy seksione të linjës së transmetimit pritet të jetë DN1200, me një gjatësi të përgjithshme prej përafërsisht. 13.46 km.

Prurjet maksimale minimale, mesatare dhe ditore për Fazën 1 janë si më poshtë:

$$Q_{\min} = 321 \text{ l/s}$$

$$Q_{\text{mes}} = 642 \text{ l/s}$$

$$Q_{d, \max} = 770 \text{ l/s}$$

Prurjet maksimale minimale, mesatare dhe ditore për Fazën 2 janë si më poshtë:

$$Q_{\min} = 573 \text{ l/s}$$

$$Q_{\text{mes}} = 1,146 \text{ l/s}$$

$$Q_{d, \max} = 1,375 \text{ l/s}$$

Tubacioni nga FPU deri në rezervuarin e Shkabaj është 2.43 km i gjatë dhe tubi pritet të jetë DN800 ndërsa tubacioni nga rezervari FPU për në Arbëri është 3.83 km dhe pritet të jetë DN800. Këto tubacione do të permasohen për sasi të mëposhtme të rrjedhjes:

FPU ne rezervuarin e Shkabaj:

$$\text{Faza 1: } Q_{\max} = 315.00 \text{ l/s}$$

$$\text{Faza 2: } Q_{\max} = 562.00 \text{ l/s}$$

FPU ne rezervuarin e Arbërisë:

$$\text{Faza 1: } Q_{\max} = 335.00 \text{ l/s}$$

$$\text{Faza 2: } Q_{\max} = 599.00 \text{ l/s}$$

Një tub DN500 (d.m.th. OD⁴ 560 mm) do të ndërtohet direkt nga FPU Shkabaj për t'u bashkuar me tubin e ri DN500 që po ndërtohet përmes Fazës II të projektit nga Rezervuari i Shkabaj në Obiliq. Gjatësia e këtij tubacioni të ri është përafërsisht. 650 m. Prurjet maksimale në këtë tubacion janë si më poshtë:

Faza 1: $Q_{\max} = 100 \text{ l/s}$

Faza 2: $Q_{\max} = 178 \text{ l/s}$

7.4.3 Materiali i tubit

Pas diskutimeve në mes të KURP-së, KfW-së dhe Konsulentit, propozimi fillestar për përdorimin e tubit të GRP-së është ndryshuar në Gize e plastifikueme me diametër DN1200 dhe DN800 dhe DN500.

Në rastin e tubit Gize e plastifikuar (DI⁵) të çimentuar me bitum nga brenda, këto do të kishin një shtresë prej 200 g / m² veshja e zinkut. Ky standard i lartë i veshjes është miratuar për të zgjatur jetën e tubacioneve.

7.4.4 Shtrati dhe mbulimi e tubave

Thellësia e mbulimit mbi kurorën e tubit do të jetë në përputhje me profilin gjatësor, do të jetë minimumi 1.2 m. Thellësitë e mbulimit të tubacioneve të transportit te ujit më të madhe se 2.5 metra do të shmangen aty ku është e mundur. Për tubat DI tubacioni do të vendoset në një shtrat të para-formuar të materialit të zhavorrit me trashësi 100 mm, për të siguruar mbështetje të vazhdueshme përgjatë zhvendosjeve dhe nën rrymat e tubave. Për tubacionet DI, do të mbulohet deri në 100 mm mbi pjesën e sipërme të tubit.

7.4.5 Kalimet e tubave

Kalimet e lumenjve

Ekzistojnë tre kalime të lumenjve, të cilat kalojnë lumin Llap dhe Sitnica përgjatë shtrirjes së tubacionit të transportit. Për secilin nga tre kalimet është propozuar që të vendosen tubat nën përrenj me tubacionin e transmisionit duke formuar një sifon të përmbysur në secilin rast. Mbulesa minimale në pjesën e sipërme të tubit do të jetë 1.2 m për çdo kalim të lumenjve.

⁴ OD - Outer Diameter

⁵ Di – Ductile iron

Kalimi hekurudhor

Për kalimin hekurudhor do të përdoret, një mbështjellëse betoni përforcuar do të punohet me një gjatësi prej rreth 10 metra. Mbështjellësja që do të jetë tërhequr do të jetë një tub betoni i përforcuar i DN1800. Tubi DN1200 do të vendoset brenda mbështjelljes në shtesa, ndërsa unazat mbyllëse do të vendosen në secilin fund të mbështjelljes, për perimetrin e saj të plotë, për të mbyllur hendekun midis mbështjellësës dhe tubacionit të brendshëm.

Kalimi i rrugëve – Tubacionet ne galeri

Për një autostradë të madhe që kalon një galeri tubi tashmë është ndërtuar një galeri e tubave, kjo do të përdoret për tubacionin e transportit te ujit DN1200. Galeria është e gjatë 8.2 m, me përmasa të brendshme 3.3 m të gjera dhe rreth 3.0 m të larta. Është prej betoni të përforcuar me një bazë 0.5 m me mure dhe çati me trashësi 0.3 m.

Një seri e bazamenteve betoni do të ndërtohet brenda galerisë se tubave për te instaluar tubin. Këto bazamente janë 1.2 x 0.6 m në plan dhe përafërsisht. 1.0 m në lartësi.

7.4.6 Analiza hidraulike

Llogaritjet specifike hidraulike për seksionet e ndryshme të tubacionit të transmisionit janë dhënë në seksionet e mëposhtme:

- Tubi kryesor, ujë rrjedhë ne saje te gravitetit nga Mihaliqi në stacionin e pompimit të Milloshevës,
- Pompimi kryesor SP i Milloshevës në FPU të Shkabaj,
- Tubi kryesor nga FPU Shkabaj për rezervuarin e Arbërisë,
- Tubi kryesor nga FPU Shkabaj për rezervuarin Shkabaj, dhe
- Tubi kryesor nga FPU Shkabaj në tubacionin nga rezervuari i Shkabaj.

7.6 Tubi kryesor me Gravitet nga Mihaliq në stacionin e pompimit të Milloshevës

7.6.1 Te përgjithshme

Tubacioni kryesor me gravitetit të ujit të papërpunuar do të lidhë ujin e papërpunuar nga Mihaliq me stacionin e pompimit në Milloshevës. Gypi kryesore do të jetë një 9.0 km DI tub DN1200, PN 10. Valvolat e ajrit do të vendosen në pusetat e armuar betoni do të ndërtohen në pika të larta. Pusetat e lëshimit do të ndërtohen në pika të ulëta. Valvoleve e sektorit do të vendoset në intervale prej rreth 2 km.

7.6.2 Dizajn hidraulik

Tubacioni kryesor i transportit te ujit me gravitetit (gjatësia 9,000 m) është projektuar për:

Nivele në marrjen - nga 552.00 në 552.40 lmd

Niveli në stacionin e pompimit (zhvendosja e aksit) - 537.15 lmd

Sasitë e prodhimit: Faza 1:

$$Q_{\min} = 321 \text{ l/s}$$

$$Q_{\text{mes}} = 642 \text{ l/s}$$

$$Q_{d.\text{max}} = 770 \text{ l/s}$$

Sasitë e prodhimit: Faza 2

$$Q_{\min} = 573 \text{ l/s}$$

$$Q_{\text{mes}} = 1,146 \text{ l/s}$$

$$Q_{d.\text{max}} = 1,375 \text{ l/s}$$

Mjedisi: Uji i papërpunuar - temperatura e ujit 4 ° C - 10 ° C

Ashpërsia e tubave të DI me veshje të brendshëm të çimentos i cili është marre ne konsideratë në analizën hidraulike është si më poshtë:

$k = 0.85$ - vlera mesatare për tubin e çelik i derdhur me veshje të çimentos

$k = 1.15$ - vlera maksimale për tubin e çelik i derdhur me veshje të çimentos

$k = 3$ - tub i hekurt gizë me korrozion te thelle

Ekuacionet hidraulike të përdorura janë si më poshtë:

Darcy – Weisbach humbje presionit ne lartësi kolloneleng: $Z_t = \lambda \frac{L}{D} \frac{v^2}{2g}$

Colebrook – White $\frac{1}{\lambda} = -\log \left[\frac{2.51}{Re\sqrt{\lambda}} + \frac{k}{3.71D} \right]$

Viskoziteti kinematike $\nu = 0.0000015671 \text{ m}^2/\text{s}$

Rezultatet e analizës hidraulike janë paraqitur në Tabelën 16 më poshtë:

Tabela 7.1: Analiza hidraulike - Marrja DN1200 deri në stacionin e pompës

DN	K	Faza	Q	l/s	m ³ /s	v (m/s)	i (o/oo)	L (m)	Zt (m)
DN 1200	k = 0.85	1.	Q _{min} =	321.00	0.3210	0.28	0.06766	9,000	0.609
			Q _{ave} =	642.00	0.6420	0.57	0.25983	9,000	2.338
			Q _{d,max} =	770.00	0.7700	0.68	0.37098	9,000	3.339
		2.	Q _{min} =	573.00	0.5730	0.51	0.20807	9,000	1.873
			Q _{ave} =	1146.00	1.1460	1.01	0.81128	9,000	7.301
			Q _{d,max} =	1375.00	1.3750	1.22	1.16262	9,000	10.464
	k = 1.15	1.	Q _{min} =	321.00	0.3210	0.28	0.07130	9,000	0.642
			Q _{ave} =	642.00	0.6420	0.57	0.27604	9,000	2.484
			Q _{d,max} =	770.00	0.7700	0.68	0.39477	9,000	3.553
		2.	Q _{min} =	573.00	0.5730	0.51	0.22081	9,000	1.987
			Q _{ave} =	1146.00	1.1460	1.01	0.86580	9,000	7.792
			Q _{d,max} =	1375.00	1.3750	1.22	1.24206	9,000	1.179
	k = 3	1.	Q _{min} =	321.00	0.3210	0.28	0.08753	9,000	0.788
			Q _{ave} =	642.00	0.6420	0.57	0.34532	9,000	3.108
			Q _{d,max} =	770.00	0.7700	0.68	0.49556	9,000	4.460
		2.	Q _{min} =	573.00	0.5730	0.51	0.27555	9,000	2.480
			Q _{ave} =	1146.00	1.1460	1.01	1.09337	9,000	9.840
			Q _{d,max} =	1375.00	1.3750	1.22	1.57185	9,000	14.147

Shifrat e dhëna më lart janë llogaritur bazuar në supozimin e një tubacioni të gjatë hidraulik ku humbjet e vogla kompensohen duke përdorur një koeficient ashpërsi të madhe (k) të tubit.

Ashpërsia k = 3 mm nuk mund të zbatohet në asnjë pjesë lineare të tubacionit, e përshkruan tubacionin rëndë të korroduar me dhe shtresa dhe përfshin humbjet e vogla në kthesa etj. Duke marrë parasysh rëndësinë e transportit të ujit nga struktura e nxjerrjes së Mihaliq dhe fakti që prurja në tub varet tërësisht nga graviteti (nuk ka mundësi për të rregulluar parametrat e pompimit) është bërë ekzekutimi i një kontrolli për të verifikuar supozimin e humbje të vogla (të papërfillshme) në krahasim me humbjet e fërkimit në tubacionin e gjatë.

Humbjet lokale llogariten sipas formulës:
$$h_m = K \frac{v^2}{2g}$$

Ku:

h_m Humbjet lokale (vogla) humbjet te lartësisë [m]

K (lokale) koeficienti I humbjeve

V shpejtësia e fluidit [m/s]

g nxitimi me gravitet

Janë llogaritur humbjet lokale:

Hyrja e tubit $K = 0.5$

Bërryl $11\frac{1}{4}^\circ$ $K = 0.025$, totali 7 copë

Bërryl $22\frac{1}{2}^\circ$ $K = 0.05$, totali 3 copë

Bërryl 45° $K = 0.1$, totali 2 copë

$$\sum K = 0.5 + 7 \times 0.025 + 3 \times 0.05 + 2 \times 0.1 = 1.025$$

Shpejtësia në tubin DN 1200 prurjen prej $1.375 \text{ m}^3/\text{s}$ është 1.22 m/s .

Humbja totale e lartësisë për shkak të humbjeve të vogla (lokale) është:

$$h_m = K \frac{V^2}{2g} = 1.025 \frac{1.22^2}{2 \cdot 9.81} \text{ m} = 0.078 \text{ m}$$

Rezultati i llogaritjes vërtetoi supozimin e humbjeve të vogla (lokale) të papërfillshme.

7.7 Stacioni i pompave të Milloshevës

7.7.1 Vendndodhja dhe layout

Distanca midis marrjes në Mihaliq dhe vendit të Stacionit të Pompave të reja të Milloshevës është 9.1 km përgjatë rrugës së tubacionit të transportit DN1200, nga ky stacion pompimi deri tek FPU në Shkabaj është një tjetër distancë 4.3 km që vazhdon përsëri linjës me tubacionit DN1200 . Lartësia (niveli i tokës) në marrjen e Mihaliqit është 552 lmd , ndërsa në stacionin e pompës të Milloshevës është 537 lmd dhe lartësia në FPU Shkabaj është përafërsisht. 595 lmd dhe niveli i terrenit është 601.00 lmd mbi te cilën është ndërtuar shkarkuesi i ajerit(ajëratori).

Vendndodhja dhe pozicionimi i pompave ne stacionin e pompave të Milloshevës "Pamja e përgjithshme" është treguar ne Figura 1. Pozicioni i stacionit të pompës është inspektuar dhe është i përshtatur nevojave te KUP.




Figura 7.1. Vëndodhja e pompave ne Milloshevë.

Duhet te përmendi se ne fazën I janë te montuara 3 pompa, dy punojnë ndërsa e treta është rezervë.

7.7.2 Përzgjedhja e pompës

Pompë duhet të jetë montuar horizontalisht duke përfshirë çarkun punues të rrjedhës së përzier me efikasitet të lartë i projektuar për të trajtuar flukse të mëdha. Pompa duhet të ketë këto shënime teknike te mëposhtme më standarde EN:

➤ Rrotori	Çelik Inoks rezistent ndaj korrozionit
➤ Bosht	Çelik Inoks
➤ Unaza e Boshtit	Çelik Inoks
➤ Statori (shtëpiza)	Gizë
➤ Këllëf me unaze durues	Zink Pa Bronz
➤ Kushinetat	Cilindrike, Lubrifikuar me yndyrë
➤ Kutia mbushëse	Rezervuar me ndërrim mekanik
➤ Xhuntot lidhëse	Mirëmbajtje me hapësirë fleksibël

Pompat duhet të jetë e montuar në një bazament ne galeri te tubave, i shtrirë për të mundësuar një lidhje pa ndërprerje të xhuntos midis pompës dhe motorit me bulona montuese siç edhe parashihet me standarde. Shtresa e brendshme te pompës duhet të jetë e veshur nga brenda me një sistem veshjesh të miratuar nga kompanitë e licencuara për Industria e Ujit për konsum njerëzorë, ndërsa nga jashtë ajo duhet të jetë e veshur me një shtresë epoksid dy shtresore. Lartësia e kërkuar statike është $601 \text{ lmd} - 552 \text{ lmd} = 49 \text{ m}$ ky është dallimi në mes të nivelit të terrenit në marrjen dhe nivelin e terrenit të FPU SHKABAJ. Humbjet ne fërkim për tubin

me gravitetit nga marrja ne Mihaliqi deri në stacionin e pompave të Milloshevës janë maksimumi 14.15 m dhe humbjet ne fërkimi për pompën kryesore nga stacioni i pompës së Milloshevës deri në FPU Shkabaj janë maksimumi 7.02 m. Uji pompohet (kapëderdhet) në nivelin e ujit në ajërtorin ne hyrje, që është 609.5 lmd, e cila është 9 m mbi terren. Ne fazën I, do te instalohen dy pompa ne operim dhe një rezervë, derisa ne fazën e II do te jenë te instaluara 4 pompa ne operim dhe dy ne rezervë.

Lloji i pompave që duhet të instalohen duhet të jetë në përputhje me karakteristikat e listuar në Tabelën 2 më poshtë:

Tabela 7.2: Karakteristikat e Pompave Pompa e ujit të pijshëm

	Njësi	Vlera
Kërkesat e Aplikimit		
Numri i njësive		3
Lëngu		Ujë
Temperatura e Pompave	°C	Ambient
Gravitet specifik		1.0
Prurja	l/s	343.75
Diferenca e Lartësive	m	84
Presioni ne thithje	m	Supozoni i përmbytur
Te dhënat e Pompës		
Diapazoni (shkalla) e Pompës		Axial Split Case
Shpejtësia (Nominalë)	Rrot/min	1470
Efikasitet	%	86.6
Fuqia e absorbuar në Xhuntot lidhëse	kW	327.08
* NPSH -Kërkesa	m	84.00
Gypi I thithjes	mm	400
Gypi Shtytës	mm	300
Presioni i Flanshëve		PN16
Rrotullimi (shihet në fund të diskut)		CW
Te dhënat e Motorit		
Fuqia	kW	450
Shpejtësia e Motorit (Nominal)		1485
Efikasiteti i motorit FL		
Motori FLC		
Furnizimi elektrik		400/3/50
Izolimi		IP55
Izolimi (Me rritjen e temperaturës së klasës B)		F

Motor elektrik do te jenë një makinë 450kW, 4 polesh, e projektuar për përdorim në një furnizim 400V / 3faza / 50Hz, dhe me një inverteri frekuencash. Makina është një dizajn IE2, me mbrojtje ne hyrje IP55 dhe do të pajiset me rezistore dhe ngrohje anti-kondensuese.

Tabela 7.3: Tabela e Kushteve të Punës

Parametrat	Prurja Totale (l/s)	Prurja për një pompë (l/s)	Lartësia (m)	Numri i pompave ne operim	Shpejtësia (rrot/min)	Efikasiteti (%)	Fuqia e absorbuar (kW)
Faza 1							
Shkalla minimale e prurjes	321	321	64.3	1	1305	86.4	234.2
Shkalla maksimale e prurjes	770	385	69.5	2	1405	85.5	306.9
Faza 2							
Shkalla minimale e prurjes	573	286.5	64	2	1275	85.9	209.5
Shkalla maksimale e prurjes	1375	343.75	84	4	1470	86.6	327.08

Seti i pompave duhet të jenë të përzgjedhura dhe me madhësi për të përmbushur kushtet e furnizimit me ujë të fazës 2. Dy pompa ne operim do të përmbushin sasinë e rrjedhës së fazës 1 sipas Tabelës 18 më sipër. Vini re se lartësia e treguar në tabelën e mësipërme është lartësia e përgjithshme duke përfshirë edhe humbjet ne fërkimit. Ne te ardhmen Pompat e Fazës 2 do të ishin makina identike, duke përfshirë pjerrtësinë e diametrave të helikës (rrotorit).

7.8 Mbrojtja nga Grushti Hidraulik

Parametrat kryesore për dizajnin e pompës janë si më poshtë:

- Faza I - 321-770 l/s
- Faza II- 573-1375 l/s
- Gypi i thithjes – DN1200, gjatësi 9 km
- Gypi ne Shtytje – DN1200, gjatësi 4.5 km

Për fazën e parë pompohet uji ne mes 321 to 770 l/s:

- Pompa 350 l/s, 84 m, 400 kW
- Operim 2 njësi +1 standby

Karakteristikat e tubave dhe pompave tregohen në diagramin e mëposhtëm:




Figura 7.2. Lakoret e pompave për fazën e parë.

Llogaritjet hidraulike janë bërë për katër skenarë të ndryshëm te Grushtit Hidraulik:

- Llogaritja 1 – me enën zgjeruese ne dalje te pompës.

Llogaritja 1

Kjo është për situatën ku stacioni i pompimit është ndërtuar me një enë zgjeruese në tubin shtytës.

Parametrat e këtyre enëve zgjeruese janë:

- Vëllimi i enës zgjeruese – 10 m³
- Numri – 4 copë

Ky skenarë paraqitet në diagramin e mëposhtëm.




Figura 7.3: Diagrami Skematik i Grushtit Hidraulik –Kalkulimi 4.

Rezultatet nga Kalkulimi 1 janë si më poshtë:

Presioni nuk ulet nën presionin e avullimit përgjatë gjithë profilit të tubit nën Presion:

- tubacioni i thithjes është më i vogël se 1.0 MPa → PN10
- tubacione I shtytjes në km 11 duhet të jetë PN16
- tubacione I shtytjes, nga km 10 duhet të jetë PN10

Ky skenarë paraqitet në diagramin e mëposhtëm:




Figura 7.4: Rezultatet e Kalkulimit i grushtit hidraulik -Kalkulimi 1.

Përfundimi nga analiza e grushtit hidraulik të ujit është se rezultatet më të mira janë marrë nga situata ku stacioni i pompimit është ndërtuar me një enë zgjeruese në dalje të pompave.

Kjo paraqet skenarin që u testua në Kalkulimin 1.

- Parametrat e këtyre enëve të ndërtuara duhet të jenë si më poshtë:
- Vëllimi i enës zgjeruese – 10 m³
- Numri – 4 copë

KAPITULLI VIII

8. SIMULIMET PËR MODELIN E ZGJEDHUR SIPAS SOFTUERIT WHAMO

Ky punim doktrate është një kontribut modest i imi sa i përket fenomenit te grushtit hidraulik ne sistemet e transportit te ujit industrial i cili me vone përpunohet për konsum njerëzore. Ne këtë punim kam prezantuar modelin matematik te fenomenit te grushtit hidraulik, duke përfshire ekuacionet e momentit dhe vazhdueshmërisë, ndërtimi i skemës se sistemit dhe skema e nyjeve ne tub. Simulimet e grushti hidraulik janë ekzekutuar duke përdorur softuerin e grushtit hidraulik (WHAMO). Simulimet japin informacion mbi parametrat e fluidit ne situata stacionare dhe jo stacionare si presionin statik dhe dinamik, shpejtësinë e fluidit dhe prurjen e tij.

Skenarët janë simuluar duke përdorur softuerin WHAMO dhe janë simuluar raste në të cilat mund te ndodhin gjate ndërhyrjes ne sistem. Ne sistemet hidraulike te mbyllur , siç është edhe rasti jonë, fenomeni i goditjes hidraulike ndodh rëndom ne rastet kur kalohet nga një gjendje e qëndrueshme ne një gjendje te paqëndrueshme. Ne këto raste energjia kinetike e masës se fluidit kthehet ne mënyre te menjëhershme ne energji presioni. Emri vjen nga tingulli qe lëshon fenomeni, tingull çekiç-goditjes qe nganjëherë ndodh gjatë fenomenit. (Parmakian 1963⁶). fenomeni i grusht hidraulik të ujit është një elementë i rëndësishme qe duhet konsideruar gjate konstruktimit e shumë strukturave hidraulike për shkak të ndryshimeve ekstreme në presionin që shkakton. Për shembull, rritja dramatike e presionit mund të shkaktojë një çarje te tubave. Duke shoqëruar valën e presionit të lartë, ekziston një valë me kahje te kundërt me rrjedhën, e cila shpesh anashkalohet, por e njëjta mund të shkaktojë presione shumë të ulëta që çojnë në mundësinë e ndërhyrjes ndotësve ne lëngun nëse ka çarje ose edhe dëmtimin e tubave.

Grushti hidraulik i ujit është një problem i zakonshëm por serioz në sistemet hidraulike të përpunimit te ujit te pijshëm. Kjo potencialisht mund të shkaktojë tensione shtesë dhe tendosjen të tubacioneve, nyjeve dhe pajisjeve tjera. Zhurma qe e shkakton grushti hidraulik mund të jetë gjithashtu një shqetësim. Për të modeluar fenomenin e grushtit hidraulik të ujit në tubat kërkohet të zgjidhen një grup ekuacionesh te momentit dhe vazhdueshmërisë qe janë dhënë ne kapitullin 4 te kësaj teme te doktoratës. Ekuacionet e momentit dhe vazhdimësisë formojnë një seri ekuacionesh diferenciale jo lineare, hiperbolike, të cilat nuk mund të zgjidhen me dorë. Modeli matematik ka shumë më shumë parametra të nevojshëm për zgjidhjen e problemit të

⁶ Parmakian; shkencëtari qe për here te parë ka përdorur emrin e Grushtit hidraulik ne vitin 1963.

grushtit hidraulik. Komplexiteti i problemit kërkon përdorimin e softuer-it për modelim. Si çdo problem i dinamikës së fluideve edhe këtu, zgjidhja do të jepet numerikisht me anë të modeleve numerike. Gjatë proceseve të gjendjeve kalimtare, pompat mund të funksionojnë në një mënyrë të pazakontë dhe jo normale. Pikërisht ne, nëpërmjet këtij punimi kemi synuar të trajtojmë numerikisht sjelljen e pompave të këtyre sistemeve gjatë fenomenit të goditje së grushtit hidraulik.

Objektivat specifikë të kësaj teme të doktoratës janë:

- *Objektivi kryesor i këtij punimi është studimi i treguesve hidraulikë, energjetikë dhe ekonomikë të trajtimit të problemeve të rrymimeve të fluidit në rrjeta hidraulike të ujit, duke vendosur si objektivin themelor për të gjetur skenarin optimal të menaxhimit të goditjeve hidraulike. Problemi i menaxhimit optimal të rrjeteve hidraulike është bazuar në aplikimin e metodave numerike për simulimin e gypit kryesor me gravitet nga Mihaliqi deri në stacionin e pompimit të ujit në Milloshevë. Kjo fushë, hidraulika e aplikuar e fluideve të pa shtypshëm, mund të përballohet vetëm me përfshirjen e specialistëve nga të gjitha fushat lidhur me të, për të përcaktuar zgjidhjen më optimale të mbështetur në një analizë të faktorëve hidraulikë dhe termodinamikë duke përdorur softuer të cilët janë të dëshmuar për këtë fushë siç është WHAMO.*
- *Krijimi i modelit matematik teorik të një sistemi të transportit të ujit industrial,*
- *Të përcaktojmë dhe analizojë parametrat baze që ndikojnë në fenomenin e grushti hidraulik.*
- *Të analizojmë këtë model transporti të ujit industrial me softuerit WHAMO, si për modelim të gjendjeve të qëndrueshëm ashtu edhe të paqëndrueshëm,*
- *Të analizojë faktorët që ndikojnë në funksionimin jonormal të pompës, dhe*
- *Të paraqesim skenarë të mundshëm të ndërhyrjes gjatë procesit të grushtin hidraulik me qëllim eliminimin e pasojave negative .*

Figura 1. tregon sistemin që e kemi marrë si objekt studimi të kësaj teme të doktoratës dhe përshkrimin e sistemit për sa i përket nyjeve dhe të dhënave të tubit. Këto të dhëna janë prezantuar në Tabelat 2,3,4 dhe 5. Sistemi fillon me një nyjë 0, një pike marrëse të ujit në lartësinë mbidetare 544.53 lmd. Sistemi ka stacion të pompave që lidhen në hyrje të SP. me nyjë 17 dhe në dalje të SP. me nyjë 18 (nyja 17 me një lartësi mbidetare nyja 532,97 lmd dhe nyja 18 me një lartësi mbidetare 534,54 lmd), pastaj vazhdohet deri në nyjë 28 e cila është edhe rezervuari i fabrikës së përpunimit të ujit në Shkabaj me një lartësi mbidetare 599.8 lmd.

Gjatësia e tubit nga marrja e ujit deri te stacioni i pompimit ne Milloshevë është 8941.17 m’, ndërsa nga stacioni i pompimit ne Milloshevë deri ne fabrikën e përpunimit te ujit “Shkabaj” është 4523.88 m’. E tërë gjatësia e tubit DN1200 nga pika marrëse deri ne fabrikës e përpunimit te ujit ne Shkabaj është 13465.05 m.

Ndryshimi i nivelit ne mes te nyjës 0, vendi i marrjes se ujit dhe stacionit te pompave, nyja 17 është 11.56 m, ndërsa ndryshimi i nivelit ne mes te stacionit te pompave, nyja 18 dhe fabrikës se përpunimit te ujit nyja 28 është 65.26m.



Karakteristikat teknike te pompave janë:

- | | |
|--------------------------------|---------------------------------|
| - Prurja | $Q = 343.00 \text{ l/s,}$ |
| - Lartësia gjeodezike | $H = 84 \text{ m,}$ |
| - Media | Ujë 100%, |
| - Densiteti | $\rho = 998.20 \text{ kg/m}^3,$ |
| - NPSH | 6.01 m, |
| - Nr. i rrotullimeve te pompës | $n = 1485 \text{ rrot/min}$ |

Informacionet e marra ne datën 18.12.2019 për stacionin e Milloshevës dhe impiantin e Shkabaj janë si me poshtë:

- presioni minimal ne hyrje ka vlerën prej 11.4 m;
- presioni maksimal ne hyrje ka vlerën prej 18 m;
- presioni minimal ne dalje ka vlerën prej 94.9 m;
- presioni maksimal ne dalje ka vlerën prej 97.6 m.

Kjo qe u tha me lartë mund te shihet edhe ne fotot qe ne i kemi prezantuar ne vazhdim.






Figura 8.2. Karakteristikat e pompave kur punojnë vetëm dhe ne paralel ne raport me numrin e rrotullimeve, rrot/min.

Ne Figura 8.2 kemi dhënë karakteristikat e pompave kur punon vetëm një pompe dhe kur punojnë paralel dy pompa për rrotullime te ndryshme te motorit te pompës, 1190 rrot/min, 1320 rrot/min dhe për numër maksimal te rrotullimeve te motorit $n = 1485$ rrot/min.

Ne tabelën 8.1 kemi informacionin bazuar ne këto te dhëna te mësipërme dhe kemi punuar grafikun e pompave i cili jepet ne vazhdim.

Tabela 8.1. Karakteristikat e pompave varësisht nga numri i rrotullimeve

Një pompe $n=1485$ rrot/min				Q1+Q2	Një pompe $n=1320$ rrot/min				Q1+Q2	Një pompe $n=1190$ rrot/min				Q1+Q2
WILO (1 pompë)				1485 rrot/min	WILO (1 pompë)				1320rrot/min	WILO (1 pompë)				1190rrot/min
Q (l/s)	H (m)	P (kW)	M (Nm)	(l/s)	Q (l/s)	H (m)	P (kW)	M (Nm)	(l/s)	Q l/s	H (m)	P (kW)	M (Nm)	(l/s)
0.00	95.70	197.40	1,270.03	0.00	0.00	75.61	138.64	1,003.48	0.00	0.00	61.45	101.58	815.56	0.00
70.10	93.00	203.10	1,306.70	140.20	62.31	73.48	142.64	1,032.45	124.62	56.17	59.72	104.51	839.10	112.35
125.70	91.60	224.80	1,446.31	251.40	111.73	72.38	157.88	1,142.76	223.47	100.73	58.82	115.68	928.76	201.46
197.60	91.50	265.80	1,710.09	395.20	175.64	72.30	186.68	1,351.19	351.29	158.35	58.76	136.78	1,098.15	316.69
250.90	91.20	301.40	1,939.14	501.80	223.02	72.06	211.68	1,532.16	446.04	201.06	58.56	155.10	1,245.23	402.12
308.50	87.20	328.80	2,115.42	617.00	274.22	68.90	230.93	1,671.44	548.44	247.22	56.00	169.20	1,358.43	494.43
347.00	84.30	351.10	2,258.89	694.00	308.44	66.61	246.59	1,784.81	616.89	278.07	54.13	180.67	1,450.56	556.13
384.00	81.10	367.00	2,361.19	768.00	341.33	64.08	257.76	1,865.63	682.67	307.72	52.08	188.85	1,516.25	615.43
436.70	75.30	391.40	2,518.18	873.40	388.18	59.50	274.89	1,989.67	776.36	349.95	48.35	201.41	1,617.06	699.90
498.30	63.70	413.00	2,657.14	996.60	442.93	50.33	290.06	2,099.47	885.87	399.31	40.91	212.53	1,706.30	798.62

Tabela 8.2. Krahësimi i prurjes dhe lartësisë gjeodezike te pompave

Q	0	200	300	400	500	600	700	800	900	1000	1100
H _c	55.27	55.98	56.8684	58.11	59.71	61.66	63.9724	66.6364	69.6556	73.03	76.7596

Ne Tabelën 8.1 jepet një përmbledhje për presionin, prurjet dhe nivelet/presionin statik për te gjithë sistemin e transportit te ujit dhe ne veçanti për nyjet qe ne kemi marre për analize (nyja 1, 5, 17 ne tubin magjistrat para stacionit te pompave dhe nyjet pas stacionit te pompave 181, 28). Ndërsa ne tabelën 8.2 jepen krahasimi i prurjes dhe lartësisë gjeodezike te pompave.

Pajisjet për mbrojtjen e sistemit te transportit te ujit nga grushti hidraulik të ujit janë si vijon:

- Enët zgjeruese

Enët zgjeruese janë lloji më i thjeshtë dhe më i besueshëm i pajisjeve për mbrojtjen nga grushti hidraulik të ujit, për sa i takon PROJEKTIMIT dhe llogaritjeve të tyre. E vetmja e metë e tyre është madhësia e tyre në sistemet me shpejtësi të lartë rrjedhëse të cilat kërkojnë një volum të madhe.

- Valvolat për shkarkim automatike te ajrit dhe valvolat për shkarkim te ujit

Këto valvola janë te vendosura ne tere gjatësinë e tubit magjistrat, ne te gjitha pozicionet ku ka ngritje dhe pastaj ulje te instalimit te tubit, ne mënyre qe mos te lejohet krijimi i jastëkëve te ajrit brena tubit kryesore DN 1200. Ne disa pozicione, ne se do paraqitet nevoja , janë vendosura edhe valvolet e sektorit dhe valvolat për shkarkimin e ujit. Edhe brenda stacionit te pompave kemi te vendosura valvola njërrugëshe qe mbrojnë pompën nga kundërgoditjet e valës se ujit. Valvolat për ç’ajrosje automatike shërbejnë për nxjerrjen e ajrit nga sistemi me qellim mos krijimin e tamponëve te ajrit prishjen e rrjedhjes normale te fluidit.

Tabela 8.3. Lista e elementeve dhe lidhjet e tyre

ID	Tipi	Nyja e parë	Nyja e dytë	Komentet
HW	Rezervuar			Rezervuar i marrjes se ujit
C1	Tub	0	1	Tub magjistrat D=1200 mm
C2	Tub	1	2	Tub magjistrat D=1200 mm
C3	Tub	2	3	Tub magjistrat D=1200 mm
C4	Tub	3	4	Tub magjistrat D=1200 mm
C5	Tub	4	5	Tub magjistrat D=1200 mm
C6	Tub	5	6	Tub magjistrat D=1200 mm
C7	Tub	6	7	Tub magjistrat D=1200 mm
C8	Tub	7	8	Tub magjistrat D=1200 mm
C9	Tub	8	9	Tub magjistrat D=1200 mm
C10	Tub	9	10	Tub magjistrat D=1200 mm
C11	Tub	10	11	Tub magjistrat D=1200 mm
C12	Tub	11	12	Tub magjistrat D=1200 mm

Tema: “Modelimi hidraulik i regjimeve te punës në tubin magjistrat Mihaliq-fabrika e përpunimit te ujit pijës Shkabaj-Prishtinë”

C13	Tub	12	13	Tub magjistrat D=1200 mm
C14	Tub	13	14	Tub magjistrat D=1200 mm
C15	Tub	14	15	Tub magjistrat D=1200 mm
C16	Tub	15	16	Tub magjistrat D=1200 mm
C17	Tub	16	17	Tub magjistrat D=1200 mm
	Nyje	17		Nyja ku lidhen pompat
C161	Tub	17	161	Tub ne hyrje te pompës
P1	Pompë	161	163	Pompe centrifugale horizontale
CH1	Valvol njërrugëshe	163	1633	Valvol njërrugëshe
C163	Tub	1633	18	Tub ne dalje te pompës
	Nyje	17		Nyja ku lidhen pompat
C162	Tub	17	162	Tub ne hyrje te pompës
P2	Pompë	162	164	Pompe centrifugale horizontale
CH2	Valvol njërrugëshe	164	1644	Valvol njërrugëshe
C164	Tub	1644	18	Tub ne dalje te pompës
	Nyje	17		Nyja ku lidhen pompat
C171	Tub	17	171	Tub ne hyrje te pompës
P3	Pompë	171	173	Pompe centrifugale horizontale
CH3	Valvol njërrugëshe	173	1733	Valvol njërrugëshe
C173	Tub	1733	18	Tub ne dalje te pompës D=250mm
	Nyje	17		Nyja ku lidhen pompat
C172	Tub	17	172	Tub ne hyrje te pompës
P4	Pompë	172	174	Pompe centrifugale horizontale
CH4	Valvol njërrugëshe	174	1744	Valvol njërrugëshe
C174	Tub	1744	18	Tub ne dalje te pompës
	Nyje	17		Nyja ku lidhen pompat
C175	Tub	17	71	Tub ne hyrje te pompës
P5	Pompë	71	72	Pompe centrifugale horizontale
CH5	Valvol njërrugëshe	72	73	Valvol njërrugëshe
C176	Tub	73	18	Tub ne dalje te pompës
C165	Tub	18	181	Tub magjistrat D=1200 mm
C19	Tub	181	19	Tub magjistrat D=1200 mm
C20	Tub	19	20	Tub magjistrat D=1200 mm
C21	Tub	20	21	Tub magjistrat D=1200 mm
C22	Tub	21	22	Tub magjistrat D=1200 mm
C23	Tub	22	23	Tub magjistrat D=1200 mm
C24	Tub	23	24	Tub magjistrat D=1200 mm
C25	Tub	24	25	Tub magjistrat D=1200 mm
C26	Tub	25	26	Tub magjistrat D=1200 mm
C27	Tub	26	27	Tub magjistrat D=1200 mm
C28	Tub	27	28	Tub magjistrat D=1200 mm
TW	Rezervuar	28		Rezervuar ne fabrikën SHKABAJ

Tabela 8.4. Karakteristikat e nyjeve

ID	Gjatësia (m)	Diametër (mm)	Shpejtësia (m/s)	Ashpërsia (m)	Koeficienti i humbjeve k
C1	204.11	1200	1229	0.028	0.5
C2	163.85	1200	1229	0.028	0.5
C3	132.24	1200	1229	0.028	0.5
C4	555.66	1200	1229	0.028	0.5
C5	60.18	1200	1229	0.028	0.5
C6	389.5	1200	1229	0.028	0.5
C7	1069.26	1200	1229	0.028	0.5
C8	1012.34	1200	1229	0.028	0.5
C9	723.46	1200	1229	0.028	0.5
C10	189.68	1200	1229	0.028	0.5
C11	57.4	1200	1229	0.028	0.5
C12	65.9	1200	1229	0.028	0.5
C13	538.17	1200	1229	0.028	0.5
C14	1726.34	1200	1229	0.028	0.5
C15	626.89	1200	1229	0.028	0.5
C16	768.11	1200	1229	0.028	0.5
C17	620.47	1200	1229	0.028	0.5
C161	3	350	1229	0.028	0.5
C163	5	250	1229	0.028	0.5
C162	3	350	1229	0.028	0.5
C164	5	250	1229	0.028	0.5
C171	3	350	1229	0.028	0.5
C173	5	250	1229	0.028	0.5
C172	3	350	1229	0.028	0.5
C174	5	250	1229	0.028	0.5
C175	3	350	1229	0.028	0.5
C176	5	250	1229	0.028	0.5
C19	1102.32	1200	1229	0.028	0.5
C20	652.38	1200	1229	0.028	0.5
C21	879.197	1200	1229	0.028	0.5
C22	671.81	1200	1229	0.028	0.5
C23	132.55	1200	1229	0.028	0.5
C24	259.1	1200	1229	0.028	0.5
C25	201.32	1200	1229	0.028	0.5
C26	94.23	1200	1229	0.028	0.5
C27	254.04	1200	1229	0.028	0.5
C28	240.04	1200	1229	0.028	0.5

Tabela 8.5. Te dhënat e Valvolave

ID	Tipi	Diametër (mm)	Pozicioni ⁷
CH1	Njërrugëshe	600	2
CH2	Njërrugëshe	600	2
CH3	Njërrugëshe	600	1
CH4	Njërrugëshe	600	1
CH5	Njërrugëshe	600	1

Tabela 8.6. Te dhënat e nyjeve

Lokacioni	ID Nyjeve	Tipi	Niveli (m)
0	Rezervuari HW	Rezervuar furnizues	544.53
1	Nyje	Nyje	528.79
2	Nyje	Nyje	528.67
3	Nyje	Nyje	518.17
4	Nyje	Nyje	516.60
5	Nyje	Nyje	513.50
6	Nyje	Nyje	518.45
7	Nyje	Nyje	513.96
8	Nyje	Nyje	522.95
9	Nyje	Nyje	532.03
10	Nyje	Nyje	533.61
11	Nyje	Nyje	534.74
12	Nyje	Nyje	530.45
13	Nyje	Nyje	535.25
14	Nyje	Nyje	522.87
15	Nyje	Nyje	528.31
16	Nyje	Nyje	533.57
17	Nyje	Nyje	532.97
161	tub	Tub, Kryqëzim P1	532.97
162	tub	Tub, Kryqëzim P2	532.97
171	tub	Tub, Kryqëzim P3	532.97
172	tub	Tub, Kryqëzim P4	532.97
175	tub	Tub, Kryqëzim P5	532.97
18	Nyje	Nyje	534.54
181	Nyje	Nyje	535.90
19	Nyje	Nyje	537.34
20	Nyje	Nyje	545.12
21	Nyje	Nyje	580.61
22	Nyje	Nyje	566.19
23	Nyje	Nyje	568.66
24	Nyje	Nyje	564.37
25	Nyje	Nyje	570.80
26	Nyje	Nyje	566.80
27	Nyje	Nyje	586.58
28	Rezervuari TW	Rezervuari ne Fabrikë	28

⁷ Pozicioni 1: përmban mbylljen e valvolave, Pozicioni 2: hapjen e valvolave.

Sidoqoftë, ky sistem i transportit të ujit industrial është pjesë përbërëse e sistemit të grumbullimit të ujit në fabrikën e ujit, pompimit të ujit në dy rezervuar, dhe pastaj shpërndahet për konsumatorë. Pompa funksionon me një numër të rrotullimeve prej 1190 rrot/min. Fuqia elektromotorit është 90 kW. Në tabelën 2 jepet lista e elementeve të tubit dhe lidhshmëria e tyre, tregohet ID e elementeve, tipi i elementit se a është rezervuar, tub etj. Jepet vendndodhja e nyjës, nyja e parë dhe nyja e dyte, etj. si dhe në fund jepen komente eventuale që mund të kemi. Në Tabelën 3. jepen karakteristikat e nyjeve si gjatësia, diametri, koeficienti i fërkimit, koeficienti i humbjeve etj. Në tabelën 4. Jepen karakteristikat e valvolave tipi, diametri dhe pozicioni i valvoleve. Në tabelën 5 karakteristikat e nyjeve siç janë vendndodhja e nyjës, emri i nyjës, tipi dhe lartësia mbidetare e secilës nyje.

Duke marre parasysh kompleksitetin e rrjetave të lëngjeve prej fazës së projektimit dhe ndërtimit të rrjeteve të reja apo optimizmin e rrjeteve ekzistuese janë zgjedhur këta skenarë:

Skenari 1 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1190$ rrot/min, $Q_{tot} = 500$ l/s.

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 2 – OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min, $Q_{tot} = 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 3 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1190$ rrot/min, $Q_{tot} = 500$ l/s, Me Enë Zgjeruese.

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 4 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min, $Q_{tot} = 700$ l/s, Me Enë Zgjeruese

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 5 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s,

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s.

(Pas 5s kemi humbje te ujit nga valvola $Q_{valv.} = 100$ l/s).

Skenari 6 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s,

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Pas 5s kemi humbje te ujit nga valvola $Q_{valv.} = 200$ l/s).

Skenari 7 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s,

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s,

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Pas 5s kemi humbje te ujit nga valvola $Q_{valv.} = 300$ l/s).

Skenari 8 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1300$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s,

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Mbyllja e valvolës V1 në nyjën J28 (koha e mbylljes se valvolës se sektorit $tv_1 = 6s$).

8.1 Skenari 1: Sistemi është në funksion me dy pompa dhe pa enë zgjeruese

Pompa punon me $n=1190$ rrot/min – Sistemi i tubit është pa enë zgjeruese 2 x Pompa me $n=1190$ rrot/min, $Q_{\text{tot}} \approx 500$ l/s.

Simulimi i parë është realizuar ne atë mënyre qe stacioni i pompave nuk ka enë zgjeruese dhe pompat kane prurje ≈ 500 l/s dy pompa dhe numër te rrotullimeve 1190 rrot/min. Ky sistem furnizohet nga një vend ku merret uji ne fshatin ne fshatin Mihaliq pastaj ne tubin e mbyllur DN 1200 uji transportohet me gravitet deri ne stacionin e pompave ne fshatin Milloshevë. Dy pompat e pompojnë ujin ne tub me presion DN1200 mm, rreth $Q = 500$ l/s deri te ajërtori i fabrikës se përpunimit te ujit “SHKABAJ”. Vlen te dimë se kjo fabrike e përpunimit te ujit për konsum njerëzor është pjese e pandashme e një sistemi për furnizim me ujë te pijshëm për disa qytete te Kosovës qendrore duke përfshi edhe kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën.

Parametrat e hyrjes për simulimin e parë janë përmbledhur në vazhdim:

Lartësia gjeodezike H (m)	Prurja e pompave Q (l/s)	Shpejtësia (m/s)	Koeficienti i humbjeve ne fërkim (m)	Nr. Rr. te pompës (min-1)	Diametri tubit mm	Ndalja e pompave t (s)	Pompat
84.00	500	1219	0.028	1190	1200	5	WILO

Në simulimin e parë, pompat punojnë ne një regjim stacionar për 5s pastaj ndodhe ndërhyrja ne sistem, ne i ndalim e pompat dhe shohim rezultatet ne vazhdim.

Vërejtje: Te gjitha tabelat e paraqitura janë te pjesshme. Llogaritjet e plota janë prezantuar ne Shtojcën nr. 1 ne forme digjitale ne CD.

Tabela 1.1. Skenari1- Te dhënat për nyjet ne tubin magjstral


SIMULATION OUTPUT															
TIME HISTORIES FOR RUN OF 10/14/19 AT 10:44:46															
TITLED: STACIONI I POMPAVE- PRISHTINE -1190 rrot/min- Pa Enë Zgjeruese															
Koha (s)	Nyja Nr. 1 Presioni Statik (bar)	Nyja Nr. 1 Prurja (l/s)	Nyja Nr. 1 Energjia potenciale (m)	Nyja Nr 5 Presioni Statik (bar)	Nyja Nr. 5 Prurja (l/s)	Nyja Nr. 5 Energjia potenciale (m)	Nyja Nr. 17 Presioni Statik (bar)	Nyja Nr 17 Prurja (l/s)	Nyja Nr. 17 Energjia potenciale (m)	Nyja Nr. 181 Presioni Statik (bar)	Nyja Nr. 181 Prurja (l/s)	Nyja Nr. 181 Energjia potenciale (m)	Nyja Nr. 28 Niveli Pizometrike (bar)	Nyja Nr. 28 Prurja (l/s)	Nyja Nr. 28 Energjia potenciale (m)
0	1.54	478.55	544.49	3.02	478.55	544.28	0.96	478.55	542.79	6.35	478.55	600.64	1.30	478.55	599.79
5	1.54	478.55	544.49	3.02	478.55	544.28	2.05	376.61	553.88	5.28	379.45	589.70	1.30	478.55	599.79
10	1.58	464.40	544.89	3.30	450.24	547.18	3.77	223.70	571.44	3.60	223.70	572.63	1.30	73.62	599.79
15	1.57	-2.83	544.83	3.26	2.83	546.72	6.23	0.00	596.52	6.24	0.00	599.54	1.30	-16.99	599.79
20	1.78	-297.33	546.96	4.26	-294.50	556.96	2.47	0.00	558.09	6.42	0.00	601.34	1.30	16.99	599.79
25	1.38	-328.48	542.91	2.18	-314.32	535.75	-0.04	0.00	532.55	6.04	0.00	597.50	1.30	11.33	599.79
30	1.49	36.81	544.04	2.75	39.64	541.51	-3.50	0.00	497.22	6.27	0.00	599.85	1.30	-16.99	599.79
35	1.43	385.11	543.43	2.47	370.95	538.73	0.76	0.00	540.75	6.40	0.00	601.19	1.30	14.16	599.79
40	1.71	186.89	546.20	3.92	186.89	553.46	3.65	0.00	570.22	6.07	0.00	597.83	1.30	5.66	599.79
45	1.64	-107.60	545.50	3.57	-113.27	549.98	4.73	0.00	581.22	6.31	0.00	600.21	1.30	-16.99	599.79
50	1.54	-382.28	544.53	3.04	-368.12	544.56	0.84	0.00	541.51	6.38	0.00	600.94	1.30	11.33	599.79
55	1.41	-79.29	543.21	2.35	-84.95	537.42	-2.29	0.00	509.60	6.10	0.00	598.08	1.30	2.83	599.79
60	1.43	198.22	543.37	2.43	198.22	538.28	-1.25	0.00	520.20	6.32	0.00	600.40	1.30	-14.16	599.79
llogaritjet, përfundohet se, nuk është konstatuar asnjë ndryshim ndaj zgjidhjes së problemit për furnizim të fabrikës së ujit. Shfrytëzimi i koncepteve teorike dhe praktike mbi rrjetin e transportit të ujit, i softuerit të gatshëm dhe i skenarëve të punuar enkas në këtë punim kanë mundësuar fitimin e rezultateve të dëshiruara, të cilat janë prezantuar në këtë punim.

- Rezultatet e fituara mund të shfrytëzohen në tërësi nga stafet e kompanive ujësjellëse. Ato vlejné si një bazë e mire teorike dhe praktike në lidhje me problemet aktuale gjatë shfrytëzimit të rrjetit në fjalë e sidomos për zgjerimet e pritura të kapaciteteve të fabrikës së ujit që duhet realizuar në të ardhmen.*

Bazuar ne kushtet paraprake te softuerit kemi plotësuar te dhënat e kërkuara siç janë:

Ne kapitullin e 8, Tabela 1. ne rrjetin modeluar, kemi paraqite karakteristikat e pompave varësisht nga numri i rrotullimeve, lista e elementeve dhe lidhjet e tyre. Tabela 2, karakteristikat e nyjëve (gjatësia, diametri, shpejtësia, ashpërsia dhe humbjet). Tabela 3, karakteristikat e valvoleve njërrugëshe. Tabela 4, te dhënat e nyjeve (lokacioni, emërtimi, tipi dhe lartësia mbidetare). Tabela 5, si dhe Skenarëve qe do ti trajtojmë ne këtë temë te doktoratës si dhe po ne këtë kapitull Tabela 6. Kemi konsideruar se, fluidi lëviz me temperaturë konstante në tubin me diametër dhe gjatësi të njohur, kemi ndërtuar modelin hidraulik të lëvizjes së supozuar si viskoze, jo stacionarë dhe njëpërmasor e me ngjeshmëri të dobët. Këto përcaktime i kemi pranuar, më tutje, të vlefshme për të gjithë punimin.

Arsyet e përzgjedhjes së skenarëve për modelin e rrjetit?

Arsye përzgjedhjes së këtyre skenarëve ka qenë se të njëjtit janë menduar që të shfrytëzohen me së shpeshti gjatë shfrytëzimit të kësaj veprë, si dhe jemi referuar praktikave dhe sasive që do të përdorën me së shumti në stacionin e pompave (nyja 17, dhe 181), referuar informatave nga terreni. Referuar fluideve që lëvizin në tuba, kemi përshkruar edhe metodat e sotme numerike për integrimin e sistemeve të ekuacioneve. Më e njohur është metoda e Hardy-Cross-it, e cila është zhvilluar dhe është aplikuar për rrjetin të modeluar për fabrikën e përpunimit të ujit (nyja 28). Ndryshimet e madhësive fizike të fluidit, përgjatë këtij seksioni, janë marrë të papërfillshme ndaj atyre në drejtim të rrjedhjes. Në vazhdim të punimit softueri në programin e vet ka definuar ekuacionet themelore diferenciale të rrjedhjes si ai i vazhdimësisë, i sasisë së lëvizjes dhe i çrregullimit të presionit.

Mbi këto koncepte, modelin e rrjedhjes stacionar e kemi kaluar në rrymimin jo stacionar, duke e formuluar si më poshtë:

- Për çdo nyje shuma e rrjedhave që hyn është e barabartë me shumën e rrjedhave që dalin nga nyja.*
- Për çdo segment gypi, patjetër duhet të vendoset raporti ndërmjet humbjeve të energjisë mekanike dhe sasive rrjedhëse, gjegjësisht të plotësohet ekuacioni i Darcy-Weisbach-ut.*

Në llogaritjet e kryera, së pari, kemi përcaktuar kriteret e parametrave themelorë të dinamikës së fluideve gjatë rrjedhjes së tyre nëpër gypat. Rëndësi të posaçme i është kushtuar përcaktimit të shpejtësisë optimale të rrjedhjes të fluidit në varësi të humbjeve të energjisë mekanike.

Karakteristikat teknike, për tubit prej çeliku të prodhuesit CNB International Corporatio Beijing, Kinë, janë marrë nga shënimet teknike për tubin prej DN1200, mbrojtje nga ana e jashtme me shtrese zink-alumin (min. 200 gr/m²) plus shtrese bitumeni (min. 70 µm) bazuar në standardin EN545. Ndërsa nga brenda do të mbrohet nga një veshje të brendshme llaç çimentoje bazuar në standardin EN545. Në bazë të kriterit të humbjeve optimale të energjisë mekanike dhe analizës së kryer kemi nxjerrë edhe rezultatet mbi fushën e përdorimit të gypave me prurjet përkatëse për rrymime optimale.

Duke marre parasysh kompleksitetin e rrjetave të lëngjeve prej fazës së projektimit dhe ndërtimit të rrjeteve të reja apo optimizmin e rrjeteve ekzistuese janë zgjedhur këta skenarë:

Skenari 1 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1190$ rrot/min, $Q_{tot} = 500$ l/s.

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 2 – OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min, $Q_{tot} = 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 3 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1190$ rrot/min, $Q_{tot} = 500$ l/s, Me Enë Zgjeruese.

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 4 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min, $Q_{tot} = 700$ l/s, Me Enë Zgjeruese

Pompë Nr. P1 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s,

Pompë Nr. P2 Ndalesa e pompës, koha e ndaljes 5.0 s.

Skenari 5 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s,

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Pas 5s kemi humbje te ujit nga valvola $Q_{valv.} = 100$ l/s).

Skenari 6 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s,

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Pas 5s kemi humbje te ujit nga valvola $Q_{valv.} = 200$ l/s).

Skenari 7 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1320$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s,

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Pas 5s kemi humbje te ujit nga valvola $Q_{valv.} = 300$ l/s).

Skenari 8 - OPERIMI I POMPAVE, $n = 1300$ rrot/min dhe $Q_{tot} \approx 700$ l/s.

Pompë Nr. P1 Punon 3000 s

Pompë Nr. P2 Punon 3000 s,

(Mbyllja e valvolës V1 në nyjën J28 (koha e mbylljes se valvolës se sektorit $tv_1 = 6s$)

➤ Nga lista e skenarëve shohim se skenari 1 dhe 3 janë identik vetëm se ndryshon sistemi me ene zgjeruese dhe pa te, si dhe sasia e ujit ndryshon te skenari 1 kemi 500l/s dh te i skenari 3 kemi 700 l/s. Pastaj njëjtë janë edhe skenari 2 dhe 4 vetëm se ndryshon sistemi pa ene zgjeruese dhe me te, si dhe sasia e ujit ndryshon te skenari 2 kemi 500l/s dh te i skenari 4 kemi 700 l/s. Duke marre parasysh qe skenari 1 dhe 3 janë te njëjte, si dhe skenari 2 dhe 4 po ashtu te njëjte atëherë do te analizohen se bashku.

Nga lista e skenarëve me lartë shohim së skenari 1 dhe 3 janë identik vetëm se ndryshon sistemi me enë zgjeruese dhe pa të, si dhe sasia e ujit ndryshon të skenari 1 kemi 500l/s dh të i skenari 3 kemi 700 l/s. Pastaj njëjtë janë edhe skenari 2 dhe 4 vetëm së ndryshon sistemi pa enë zgjeruese dhe me të, si dhe sasia e ujit ndryshon te skenari 2 kemi 500l/s dh te i skenari 4 kemi 700 l/s. Duke marre parasysh qe skenari 1 dhe 3 janë te njëjte, si dhe skenari 2 dhe 4 po ashtu te njëjte atëherë do te analizohen se bashku.

Ne skenarin 1 pika me kritike në gjithë tubin dhe stacionin e pompave është nyja 17 e cila gjendet në hyrje të stacionit të pompave. Ne nyjën nr. 17 presioni në fillim të punës e kemi 0.96 bar, pas ndërhyrjes në sistem kemi një rritje të presionit nga 596.52 m në sekondën 15, pastaj presioni bie në 497.22 m në sekondën 30 d.m.th. rritje të presionit për 99.3 m (9.93 bar) kjo është një situatë e rrezikut të lartë (shih Figura 1.3).

Skenari 1. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 1.3. Krahاسimi i presionit punues në disa nyje në tubin magjstral, pa enë zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1190$ rrot/min.

Por edhe ne skenarin 3 pika me kritike ne gjithë tubin dhe stacionin e pompave është nyja J17 shih (fig. 3.3) paraqet situatë të rrezikshme për sistemin sepse kemi një ndryshim presioni në sekondën

e 15 në 593.45 m, pastaj në sekondën 25 bie në 497.49 m. Kjo diferencë 96 m (9.6 bar) është një diferencë e konsiderueshme e presionit brenda në tub dhe e cila edhe mund të dëmtoj tubin në këtë nyje, në hyrje të stacionit të pompave. Praktikisht kjo është edhe gjendja e rrezikshme edhe pse zgjate vetëm 10 sekonda. Kjo situatë shkaktohet për shkak të ndërhyrjes, ndaljes së pompave dhe për shkak të oscilimeve të vëllimit të madh të ujit që e godet këtë nyje pas ndërprerjes të punës së pompave.

Skenari 3. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 3.3. Krahësimi i niveleve në disa nyje në tubin me enë zgjeruese, me numër të rrotullimeve të pompës $n=1190$ rrot/min.

Softueri në këtë rast na jep paralajmërim se këtu mund të kemi dëmtim të tubit për shkak të rritjes së presionit.

Kjo ndodhë për arsye të oscilimeve të volumit të ujit si shkak i konfiguracionit të instalimit të tubit. Ndërsa në nyjet nr. 1, 5 dhe në nyjën nr. 181 dhe 28 nuk kemi ngjarje të cilat ndodhin gjatë këtij skenari që do ta rrezikojnë sistemin e transportit të ujit në përgjithësi.

- *Bazuar në këtë rezultat që na jep softueri për llogaritjet hidraulike rekomandojmë që të sigurohet ky sektorë i tubit (nyja 17) me një valvol automatike për rregullimin e presionit të ujit në këtë pjesë tubi. Kjo valvol sigurose do të aktivizohet ose hapet nëse presioni në atë nyje rritet mbi 10 bar (edhe pse tubi është PN12 d.m.th kemi rezerve presioni) dhe kjo sasi e ujit rekomandojmë të lidhet me sistemin e kanalizimit në mënyrë që mos të krijoj probleme me rrethinën.*

- *Llogaritja e parametrave të punës të valvolës siguruese dhe llojit duhet të jenë temë e një punimi shkencorë të veçantë në të ardhmen nga ana e studiuesve qoftë ata të jashtëm ose edhe nga KURP dhe do të shfrytëzohen nga të gjithë ata të cilët merren me projektimin e rrjetave të reja apo me rikonstruktimin e tyre.*

Ne vazhdim po paraqesim modelin e valvolave siguruese mekanike si dhe një shembull se si instalohet ajo ne sistemin e ujit.




Figura 5. Valvola siguruese mekanike.

- Me logjike e njëjtë vazhdojmë edhe për skenarët 2 dhe 4.

Ne skenarin 2 Presioni statik ne nyjën J17, shih Figura 2.3 paraqitet një situatë jo shumë e favorshme për sistemin sepse pas 15 s presioni rritet në 600.52 m, pastaj në sekondën 30 bie në 514.11 m (8.64 bar) që kjo është një diferencë që edhe mund të dëmtoi tubin në këtë nyjë por nuk është e rrezikshme si skenari 1. Ne nyjën J181 presioni statik ka diferencë në fillim të punës së pompave kemi nivelin 601.86 m dhe pas 10 s bie nivel 571.47 m dhe pas 20s t tjera kemi nivelin 624.44 m, rrjedhimisht kemi një diferencë 52.97 m (5.29 bar) kjo është një situatë dhe presion i favorshme për sistemin në tërësi.

Skenari 2. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 2.3 Krahاسimi i presionit punues ne disa nyje në tubin magjstral, pa enë zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min.

Ne skenarin 4 presionit statik ne nyjën J17 (fig. 4.3) paraqet rrezikshmëri të nivelit të mesëm për sistemin sepse në fillim të punës së pompave kemi një nivel 540.87 m dhe pas 15 s presioni rritet në 598.93 m, dhe në sekondën e 30 bie presioni në nivelin 511.58 m, d.m.th. pas ndaljes së pompave kemi një diferencë prej 87.35 m (8.7 bar) dhe kjo situatë është nuk është normale mundësia që të dëmtohet tubi i ujit ekziston por me një rrezik të mesëm sepse kemi tubin me PN 12 bar, d.m.th. kemi presion rezerve.

Pastaj në sekondën 30 bie në 511.97 m dhe vazhdon kështu të bie presioni për çdo 15 s për 0.2 bar dhe rreziku i dëmtimit të tubit në këtë nyjë është i vogël pas sekondës së 45. Kjo është një situatë e rrezikut të mesëm. Pas kësaj gjendjeje presioni statik bien si në drejtim të rrjedhjes së ujit po ashtu edhe në drejtim të kundërt përafërsisht çdo 25-30 sekonda bien për 2.63m afërsisht (0.26 bar).

Skenari 4. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 4.3. Krahasoni i presionit punues ne disa nyje ne tubin magjistrat me enë zgjeruese, me numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min.

Sa i përket presionit statik ne nyjën J181 kemi një presionit statik ne fillin nga 601.58 m sa është ne fillim ne 600.88 m ne sekondën e 10 d.m.th. menjëherë pas ndaljes së pompave kemi një difference prej me pak së 1 m dhe kjo shtate nuk mund të krijoj kushte që të na paraqitet kavitacionit respektivisht edhe mundësia e shkatërrimit të tubit ne këtë nyje nuk është e mundur.

- Sikurse të krahasimi i skenarëve 1 dhe 3 po ashtu edhe këtu që krahasojmë skenarët 2 dhe 4 rekomandimi është i njëjte. Bazuar ne këtë rezultat që na japin llogaritjet hidraulike rekomandojmë KURP që të sigurohet ky sektorë i tubit (nyja J17) me një valvol automatike për zbutjen e presionit të ujit ne këtë pjesë tubi. Kjo valvol siguroese do të aktivizohej ose hapej nëse presioni në atë nyje rritet mbi 10 bar (edhe pse tubi është PN12 d.m.th kemi rezerve presioni) dhe kjo sasi e ujit të lidhet me sistemin e kanalizimit qe mos te ndikoi ne rrethinën.
- Shfrytëzimi i softuerëve të gatshëm ndikon në shkurtimin e kohës për arritjen e rezultateve llogaritëse. Ky softuer mund të shfrytëzohet nga ekspertet që e njohin softuerët të ngjashëm por edhe nga ata të cilët njohin gjuhë kompjuterike për hartimin e programeve të ngjashme për këto lloj materie. Këto të dhënat teknike, mbi presionet statike, prurjet, lartësitë gjeodezike ne nyje si dhe të dhënat teknike për pajisjet e tubit e sidomos mbi pompat, mund të shfrytëzohen si parametra teknike gjatë studimit të mundësive për eliminimin e problemeve që mund të shfaqen në të ardhmen ne rrjetin e transportit të ujit të papërpunuar të fabrikës së ujit (nyja J28).

➤ Sa ju përket skenarëve 5, 6 dhe skenarit 7 ata janë të njëjtë vetëm që ndryshon sasia e humbjes së ujit ne rrjet konkretisht 100 l/s skenari i 5, 200 l/s skenari 6 dhe 300 l/s skenari 7.




Figura 7.1 Skema e sistemit skenarët 5, 6 dhe 7.

Sa i përket skenarit 5 kemi këto rezultate:

Në këtë skenar, presioni ne hyrje stacionit të pompave është 0.76 bar dhe ne dalje të stacionit të pompave është 6.57 bar, ndërsa prurje e dy pompave është 702.26 l/s. Pompa funksionon me $n=1320$ rrot/min, fuqia e elektromotorit të pompës $P=281.28$ kW. Ndërhyrja ndodhe ne sekondën e 5, kur në valvolën V51 kemi shpërthim të tubit dhe humbje të ujit 100 l/s.

Siç mund të shohim edhe nga figura 5.2, 5.3 dhe 5.4, presioni, prurjet dhe presioni statik ne të gjitha nyjet për kohën derisa nuk kemi ndërhyrje ne sistemin e transportit të ujit janë konstante dhe te pa ndryshuara. Ne sekondën e 5 kemi ndërhyrje ne sistem d.m.th humbje te ujit ne nyjën V51 (lidhet me nyjën J5) rreth 100 l/s, ndryshon situata ne nyjet.

Skenari 5. Presioni punues i ujit ne nyjet, p (bar)




Figura 5.2 Krahaskimi i presionit ne disa nyje ne tubin magjistrat me numër te rrotullimeve të pompave $n=1320$ rrot/min, dhe humbje të ujit $Q_{vent}=100$ l/s.

Skenari 5. Prurjet e ujit ne nyjet, Q (l/s)




Figura 5.3 Krahاسimi i prurjeve ne disa nyje ne tubin magjstral dhe me numër të rrotullimeve të pompave $n=1320$ rrot/min, humbje të ujit $Q_{vent}=100$ l/s.

Skenari 5. Vlerat e energjisë potenciale H(m)




Figura 5.4 Krahاسimi i presionit punues ne nyje ne tubin, me numër të rrotullimeve të pompave $n=1320$ rrot/min, dhe humbje të ujit $Q_{vent}=100$ l/s.

Nga Fig. 5.5, krahasimi midis energjisë potenciale maksimale dhe energjisë potenciale minimale si dhe Fig.5.6 krahasimi i energjisë potenciale dhe prurjes minimale ne nyje ne tubin me numër të rrotullimeve të pompave $n=1320$ rrot/min, dhe humbje të ujit $Q_{vent}=100$ l/s.

Këtu mund të shohim se sasia që marrin pompat në fillim është 702.26 l/s derisa nuk kemi humbje të ujit, ndërsa pas shpërthimit të tubit prurja maksimale që merret nga kanali Ibër-Lepencit (d.m.th. pas shpërthimit të tubit kemi humbje ne rrjetin përafërsisht 100 l/s) është 807.03 l/s dhe tani ne tub kemi prurje të ujit 707.92 l/s pas njëjës J5, pas shpërthimit të tubit. Humbja e ujit është ne

proporcion të drejt me sasinë para dhe pas vendit të shpërthimit (humbjeve) të ujit (d.m.th. 702.26 l/s shtojmë edhe humbjen prej 100 l/s totali është përafërsisht i njëjte me sasinë maksimale kur të merren parasysh edhe humbjet).

Skenari 5. Krahasimi midis energjisë potenciale max. dhe energjisë potenciale min.




Figura 5.5 Krahasimi i presionit statik ne nyje ne tubin magjistrat me numër të rrotullimeve të pompave $n=1320$ rrot/min, dhe humbje të ujit $Q_{vent}=100$ l/s.

Skenari 5 -Nivelit dhe prurja minimale




Figura 5.6 Krahasimi i energjisë potenciale dhe prurjes maksimale ne nyje ne tubin me numër të rrotullimeve të pompave $n=1320$ rrot/min, dhe humbje të ujit $Q_{vent}=100$ l/s.

Softueri WHAMO nuk merret me ndryshimin e fazave, kështu që simulimi me softueri WHAMO nuk jep ndonjë paralajmërim për rrezik të sistemit dhe shkatërrim të kolonës se ujit e me këtë edhe shkatërrimin e tubit ose edhe të çarkut punues të pompave.

➤ Për skenarit 6 kemi këto rezultate, presioni ne hyrje stacionit të pompave është 0.76 bar dhe ne dalje të stacionit është 6.57 bar, ndërsa prurje e dy pompave është 702.26 l/s. Pompa funksionon me $n=1320$ rrot/min, fuqia e elektromotorit $P=281.28$ kW. Ndërhyrja ndodhe ne sekondën e 5, kur ne valvolën V51 kemi shpërthim të tubit dhe humbje të ujit 200 l/s. Siç mund te shohim edhe nga figura 6.2, 6.3 dhe 6.4, presioni, prurjet dhe presioni statik ne të gjitha nyjet për kohën derisa nuk kemi ndërhyrje ne sistemin e transportit të ujit janë konstante dhe të pa ndryshuara. Ne sekondën e 5 kemi ndërhyrje ne sistem ne nyjën V51 (lidhet me nyjën J5) rreth 200 l/s, ndryshon situata ne nyjet.

Skenari 6. Presioni punues i ujit ne nyje p (bar)




Figura 6.2 Krahاسimi i presionit te ujit në nyje ne tubi magjistrat, me enë zgjeruese me numër të rrotullimeve $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=200$ l/s.

Skenari 6. Prurjet e ujit ne nyje Q (l/s)




Figura 6.3 Krahاسimi i prurjeve te ujit ne disa nyje ne tubin magjistrat, me enë zgjeruese me numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=200$ l/s.

Skenari 6. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 6.4 Krahassimi i presionit punues ne disa nyje në tubin magjstral, me enë zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent} = 200$ l/s.

Nga Fig. 6.6 shohim krahasimi energjisë potenciale maksimal dhe prurjes maksimale ne nyje në tubin magjstral, me ene zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=200$ l/s.

Skenari 6 -Niveli dhe prurja maksimale




Figura 6.6. Krahassimi i energjisë potenciale max. dhe prurjes max. në tubin magjstral, me enë zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent} = 200$ l/s.

Këtu mund të shohim se sasia që marrin pompat ne fillim është 702.26 l/s derisa nuk kemi humbje të ujit, ndërsa pas shpërthimit të tubit prurja maksimale që merret nga kanali Ibër-Lepencit (d.m.th.

pas shpërthimit të tubit kemi humbje ne rrjetin përafërsisht 200 l/s) është 917.47 l/s dhe tani ne tub kemi prurje të ujit 710.75 l/s pas nyjës J5, pas shpërthimit të tubit. Humbja e ujit është ne proporcion të drejt me sasinë para dhe pas vendit të shpërthimit (humbjeve) të ujit (d.m.th. 702.26 l/s shtojmë edhe humbjen prej 200 l/s totali është përafërsisht i njëjte me sasinë maksimale kur të merren parasysh edhe humbjet).

Softueri WHAMO nuk merret me ndryshimin e fazave, kështu që simulimi me softueri WHAMO nuk jep ndonjë paralajmërim për rrezik të sistemit dhe shkatërrim të kolonës se ujit e me këtë edhe shkatërrimin e tubit ose edhe të çarkut punues të pompave.

➤ Për skenarit 7 kemi këto rezultate, presioni ne hyrje stacionit të pompave është 0.76 bar dhe ne dalje të stacionit të pompave është 6.57 bar, ndërsa prurja e dy pompave është 702.26 l/s. Pompa funksionon me $n=1320$ rrot/min, fuqia e elektromotorit të pompës $P=281.28$ kW. Ndërhyrja ndodhe ne sekondën e 5, kur ne valvolën V51 kemi shpërthim te tubit dhe humbje te ujit 200 l/s.

Nga figura 18, 19 dhe 20 shohim se presioni, prurjet dhe presioni statik në të gjitha nyjet për kohën derisa nuk kemi ndërhyrje ne sistemin e transportit të ujit janë konstante dhe të pa ndryshuara. Në sekondën e 5 kemi ndërhyrje ne sistem d.m.th humbje të ujit ne nyjën V51 (lidhet me nyjën J5) rreth 300 l/s, ndryshon situata ne nyjet.

Skenari 7. Presioni punues i ujit ne nyje p (bar)




Figura 7.2. Krahassimi i presionit të ujit në nyje ne tubi magjistrat, më enë zgjeruese me numër të rrotullimeve $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=300$ l/s.

Skenari 7. Prurjet e ujit ne nyje Q (l/s)




Figura 7.3. Krahasoni i prurjeve të ujit ne disa nyje ne tubin magjistrat, më enë zgjeruese me numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=300$ l/s.

Skenari 7. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 7.4 Krahasoni i presionit punues ne disa nyje në tubin magjistrat, me enë zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=300$ l/s.

Nga Fig. 7.5 Krahasoni energjisë potenciale maksimal dhe prurjes maksimale ne nyjet në tubin me numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=300$ l/s.

Këtu mund të shohim se sasia që marrin pompat ne fillim është 702.26 l/s derisa nuk kemi humbje të ujit, ndërsa pas shpërthimit të tubit prurja maksimale që merret nga kanali Ibër-Lepencit (d.m.th. pas shpërthimit te tubit kemi humbje ne rrjetin përafërsisht 300 l/s) është 1019.41 l/s dhe tani ne tub kemi prurje të ujit 713.58 l/s pas nyjës J5(qe lidhet me nyjën V51), pas shpërthimit te tubit.

Skenari 7 - Hmax dhe Qmax




Figura 7.5 Krahësimi energjisë potenciale maksimale dhe prurjes maksimale në nyjet në tubin me numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{vent}=300$ l/s.

Humbja e ujit është në proporcion të drejt me sasinë para dhe pas vendit të shpërthimit (humbjeve) të ujit (d.m.th. 702.26 l/s shtojmë edhe humbjen prej 300 l/s totali është përafërsisht i njëjte me sasinë maksimale kur të merren parasysh edhe humbjet).

Softueri WHAMO nuk merret me ndryshimin e fazave, kështu që simulimi me softueri WHAMO nuk jep ndonjë paralajmërim për rrezik të sistemit dhe shkatërrim të kolonës së ujit e me këtë edhe shkatërrimin e tubit ose edhe të çarkut punues të pompave.

- Bazuar në këto rezultat që na japin llogaritjet hidraulike rekomandojmë KURP që të sigurohen puna e pompave në të thatë, sepse nëse kemi humbje të ujit në sasi me të mëdha se 300 l/s atëherë, kapaciteti i gypit nuk mund të furnizon me shumë se 1250 l/s dhe mund të rrezikohen pompat.
Për të shmangur punën në të thatë të pompave, thjesht mund të instalohet një pajisje mbrojtëse e punës në të thatë e cila ndalon pompën menjëherë në rast të rrezikut të funksionimit në të thatë.

➤ Sa i përket skenarit 8 kemi këto rezultate, pompa punon $n=1320$ rrot/min, me prurje të pompave $Q_{\text{tot}} \approx 700$ l/s, sistemi i transportit të ujit punon pa pengesa deri ne sekondën e 6 kur kemi mbyllje të valvolës se sektorit V1 në nyjën J28.




Figura 1. Skema e sistemit, skenari i tetë

Skenari i 8- stacioni i pompave ka ene zgjeruese dhe pompat kane prurje rreth 700 l/s dhe numër të rrotullimeve 1320 rrot/min, pas 25 sekondave i ndalim pompat. Uji merret në fshatin Mihaliq pastaj me tubin me gravitet uji vjen deri të stacioni i pompave. Nga këtu pompat e pompojnë ujit ne tub 1200 mm, rreth $Q=614.48$ l/s deri tek rezervuari në fabrikën e përpunimit të ujit. Ne figura 8.2, 8.3 dhe Figura 8.4 shohim krahasimi i presionit të ujit, krahasimi i prurjeve dhe i presionit statike në nyje të tubi magjistrat, me enë zgjeruese me numër të rrotullimeve $n=1320$ rrot/min, $Q_{\text{tot}}=700$ l/s, mbyllja V1.

Skenari 8. Presioni i ujit ne nyje p (bar)




Figura 8.2. Krahasimi i presionit të ujit në nyje ne tubi magjistrat, me enë zgjeruese me numër të rrotullimeve $n=1320$ rrot/min, $Q_{\text{tot}}=700$ l/s, mbyllja V1.

Skenari 8. Prurjet e ujit ne nyje Q (l/s)




Figura 8.3. Krahاسimi i prurjeve të ujit ne disa nyje ne tubin magjistrat, me enë zgjeruese me numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{tot}=700$ l/s, mbyllja V1.

Skenari 8. Vlerat e energjisë potenciale H (m)




Figura 8.4. Krahاسimi i presionit statike ne disa nyje në tubin magjistrat, me enë zgjeruese dhe numër të rrotullimeve të pompës $n=1320$ rrot/min, $Q_{tot}=700$ l/s, mbyllja V1.

Ne Figura 8.5, sipas skenarit të mbylljes së valvolës V1, paraqitet mbyllja brenda 6s lakorja e plotë ngjyre të kuqe (përqindja e mbylljes së valvolës), si dhe prurja në valvolën V1 lakorja me ngjyre blu e plotë, (prurja në funksion të kohës), pastaj kemi dhe lakoren e prurjes në enën zgjeruese, lakorja me ngjyre të zeze e plotë. Siç mund te shihet ne Figura 5, deri ne sekondën e 6 (kur te mbyllet valvola V1), ne enën zgjeruese kemi prurje te ujit me sasi 113.27 l/s.

Skenari 8. Prurja e pompave $Q=f(t)$ dhe pozicioni i valvolës $A_v = f(\%)$




Figura 8.5 Krahësimi i përqindjes së hapjes V1 gjatë 6s, dhe sasia e ujit që futet në enën zgjeruese.

Ne sekondën e 9 kemi prurje në enën zgjeruese 858 l/s, pastaj kemi një oscilim ku prurja bie në 421.92 l/s dhe kështu vazhdon të ketë prurje në enën zgjeruese deri në sekondën e 25. Nga kjo kohë fillon të bie prurja në enën zgjeruese pastaj prurja në sekondën e 27.5 është 62.30 l/s dhe në sekondën e 50 bie në 0 l/s. Në Figura 8.5 shohim se derisa valvola V1 nuk ka qenë e mbyllur në enën zgjeruese ka pas rrjedhje të ujit me sasi 113.27 l/s, pas mbylljes së valvolës V1 kjo sasi e ujit është rritur shumë deri në 858 l/s në sekondën e 9, pastaj kemi një oscilim ku prurja bie në 421.92 l/s dhe kështu vazhdon të ketë prurje në enën zgjeruese deri në sekondën e 25, koha kur fiken pompat. Këtu ky oscilim i ujit krijon rritje të sasisë së ujit në enët zgjeruese, d.m.th. uji shkon edhe nga pompat në enë zgjeruese po edhe nga kthimi i ujit nga gypi në dalje të stacionit të pompave (kthehet uji pasi është mbyllur valvola e sektorit V1), vlen të theksohet se presioni në sekondën e 25 është 7.29 bar. Kjo nuk është situatë shumë e rrezikshme por mund të bëhet situatë e rrezikut mjaftë të lartë nëse pas 6 sekondave që mbyllet valvola V1, pompat do të vazhdonin të punonin edhe me gjatë se 25 sekonda atëherë do të kishim një situatë që në çdo moment do të dëmtohen pajisjet në enët zgjeruese ose të pompave dhe mundësi tjetër është të dëmtohet edhe tubi kryesor.

- *Bazuar në këto rezultat që na japin llogaritjet hidraulike rekomandojmë KURP që të sigurohen puna e pompave në të thatë, sepse nëse kemi humbje të ujit më të mëdha se 300 l/s atëherë, kapaciteti i gypit nuk mund të furnizon me shumë se 1250 l/s dhe mund të rrezikohen pompat. Për të shmangur punën në të thatë*

të pompave, thjesht mund të instalohet një pajisje mbrojtëse e punës në të thatë e cila ndalon pompën menjëherë në rast të rrezikut të funksionimit ne të thatë.

Bazuar në krahasimin e vlerave aktuale te prurjes se pompave me vlerat e provës së performancës së projektimit, ne terren është konstatuar një devijim në efikasitetin e pompës nga 86 % në 61.8%. Ky devijim ka ndikim të drejtpërdrejtë në konsumimin e me shumë të energjisë për transport të së njëjtës sasi uji krahasuar me pompën e projektuar.

Kursimi vjetor i energjisë nga një pompë në vend për një vit është: $83.06 \text{ kWh} \times 24 \times 365 = 727,605.6 \text{ kWh}$. Nëse e dimë që çmimit për 1 kWh është 0.08 €, atëherë për një pompë për një afat një vjeçare nëse do te merret parasysh rekomandimi i dale nga ky punim doktrate do të kursenin Kompania e Ujësjetllësit Rajonal “PRISHTINA”, 58,208.44 €.

Kur te dihet se zakonisht punoje dy pompa atëherë kursimi do te dyfishohej d.m.th. $58,208.44 \text{ €} \times 2 = 116,416.89 \text{ €}$ për një vite do te kursente Kompania e Ujësjetllësit Rajonal “PRISHTINA”.

- *Bazuar ne këto rezultat që na japin llogaritjet e mësipërme rekomandojmë Kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal “PRISHTINA” për të ju ikur shpenzimeve të panevojshme financiare, të ndërmerr këto veprime:*

- 1. Zëvendësimi i pompave joefikase,*
- 2. Korrektimi i pasaktësive gjatë përzgjedhjes së pompave,*
- 3. Gdhendja e çarkut punues te pompave, etj.*

Ky rekomandim besoi se është i arsyeshëm dhe është ekonomik, mendoi se brenda tri viteve do te nxjerrshin investimet qofte edhe ne pompa te reja ose edhe ndërhyrja ne ato aktuale.

10.LITERATURA

1. Prof. Isuf REÇI, “*HIDRAULIKA E PËRGJITHESHME*”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1999;
2. Demneri, I., “*Impiante të Industrisë*”, Universiteti i Tiranës, 1985;
3. Prof. Andonag LONDO, Prof. Robert PLUMBI, “*Mekanika e Fluideve*”, Ribotim, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2009;
4. Demneri I., Shtjefni A., Karapici R., “*Termoteknika*”, Tiranë, 2003;
5. Krasniqi, F., Selimaj, R., Malsiu, I., “*Instalimet Makinerike*”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004;
6. Fox, W. R, McDonald, T. A., “*Introduction to the Fluid Mechanics*”, Fifth Edition, John Wiley & Sons, INC, 1998;
7. Wylie, E. B., Streeter, V. L., Suo, L., “*Fluid Transients in Systems*”, Prentice Hall, Englewood Cliffs, New Jersey, 1993;
8. Streeter, V. L., Wylie, E. B., “*Fluid Mechanics*”, First SI Metric Edition, McGraw-Hill Book Company, 1986;
9. Fox, J. A., “*Hydraulic Analysis of Unsteady Flow in Pipe Networks*”, Second Edition, The Macmillan Press, LTD, London, 1979;
10. Bird, R. B., “*The Equations of Change and the Macroscopic Balances*”, Chemical Engineering Science, 1957, Vol. 6, 123 – 131;
11. Fox, J. A., “*Transient Flow in Pipes, Open Channels and Sewers*”, John Wiley & Sons, New York, 1989;
12. Bird, R. B., Steward. W. E., Lightfoot, E. N.: “*Transport Phenomena*”, J. Willey International Edition, New York, 1960;
13. Hanjalic, K., “*Dinamika stisljivog fluida*”, Svjetlost, Sarajevo, 1978;
14. Michael Frankel, “*Facility Piping Systems Handbook*”, Second Edition, McGraw-HILL, New York, 2002;
15. Bruce E. L., Roland W. J., Gary Z. W., “*Hydraulics of Pipeline Systems*”, CRC Press, Washington, D.C., 2000;
16. Alfirević, I., “*Mehanika kontinuuma*”, Tehnicka enciklopedija 8, Leksikografski zavod, Zagreb, 1982, 173 – 187;
17. Faye C. M., Jerald D. P., Jeffrey D. S., “*Heating, Ventilating, and Air Condi-tioning*” Analysis and Design, Fifth Edition, John Wiley & Sons, Inc., 2000;
18. Berisha, Xh., “*Hidrodinamicka analiza slozenih cjevovodnih sistema*”, Punim magistrature, Sveuciliste u Zagrebu, FSB, Zagreb, 1989;
19. Doliner, Z., “*Predavanja iz kolegija Mehanika fluida i Transportni procesi*”, FSB, Zagreb, 1993;
20. Doliner, Z., Virag, Z., “*Hidrodinamicki modeli jednodimenzionalnog strujanja fluida*”, Zagreb, Zbornik radova, 45 – 49, 1991;
21. Jordan, V., “*Prehodni rezimi v hidravlicnih cevni sistemih*”, TOZD Založba, Ljubljana, 1983;
22. Kraut, B., “*Strojarski prirucnik*”, Tehnicka knjiga, Zagreb, 1982, 157-162;

23. Alfirevic, I., Virag, Z., “*Strujanje u cjevovodima*”, Inzenjerski prirucnik IP1, Skolska knjiga, Zagreb, 1996;
24. Maran J.M.; Shapiro N.H., “*Fundamentals of Engineering Thermodynamics*” 4 Edition, Vol.II Chapters 8-14, John Wiley & Sons, INC, 2000;
25. Sasic, M., “*Transport fluida cevima*”, Masinski fakultet, Beograd, 1982;
26. Bisgaard, C., Sorensen, H. H., Spangenberg, S.: “*A Finite Element Method for Transient Compressible Flow in Pipelines*”, International Journal for Numerical Methods in Fluids, Vol. 7, 1987, 291 – 303;
27. Flatt, R., “*Unsteady Compressible Flow in Long Pipelines Following a Rupture*”, International Journal for Numerical Methods in Fluids, Vol. 6, 1986, 83 – 100;
28. Nathan, G. K., Tan, J. K., Ng, K. C., “*Two Dimensional Analysis of Pressure Transients in Pipelines*”, International Journal for Numerical Methods in Fluids, Vol. 8, 1988, 339 – 349;
29. Voronjec, K., “*Dopuna kursu mehanike fluida*”, Masinski fakultet, Beograd, 1975;
30. Hughes, W., Brighton, J., “*Theory and Problems of Fluid Dynamics*”. McGraw –Hill Book Company, New York, 1970;
31. Koharic, V., “*Uvod u projektiranje cjevovoda*”, Fakultet strojarstva I brodogradnje, Zagreb, 1986;
32. Salnjikov, V., “*Dinamika viskoznog nestisljivog fluida*”, Masinski fakultet, Beograd, 1969;
33. Sedmak, S., “*Savremeni aspekti projektovanja i izrade sudova i cevovoda pod pritiskom*”, Teholosko – Metalurski Fakultet, Beograd, 1982;
34. Giles, R., “*Theory and Problems of Fluid Mechanics and Hydraulics*”, McGraw – Hill Book Company, New York, 1970;
35. John, J. E. A., Haberman, W., “*Introduction to Fluid Mechanics*”, Prentice – Hall, INC, New Jersey, 1971;
36. Krasniqi F., Demneri, I., Berisha, Xh., “*Llogaritja e rrjetave hidraulike me ndihmën e programit MS EXEL*”, Shoqata Termoteknike Shqiptare, Tiranë, 2002;
37. Fancev M., “*Mehanika fluida*”, Tehnicka enciklopedija, Svezak VIII, Zagreb, 1982, 67–173;
38. Markivski M., “*Cevni vodovi*”, Masinski fakultet, Beograd, 1987;
39. Doliner Z., Virag, Z., “*Studija zastite od hidraulickog udara crpne stanice ”Park”, vodovodni system Batlava – Pristina*”, Izvjestaj br. 79, Zagreb, 1984, 1 – 13;
40. Doliner Z., Virag, Z. Matijasevic, B., “*Studija zastite od hidraulickog udara crpnih stanica Vranjevac II i Maticane III, vodovodnog sistema Batlava – Pristina*”, FSB Sveucilista u Zagrebu, Zavod za energetska postrojenja, Zagreb, 1983, 1 – 37;
41. Zlokarnik M., “*Dimensional Analysis and Scale-up in Chemical Engineering*”, Springer-Verlag, Berlin, 1991;
42. Stratobërdha P., “*Hidraulika e zbatuar*”, ShBLU, Tiranë, 2001;
43. Krasniqi F., Shtjefni A., Berisha Xh., “*l'influenza dei parametri idraulici al consumatore cricito*”, xxxii-convegno nazionale "ingegneria e impiantistica italiana", rimini –italia. punimi është aprovuar për referim me datën 6-7 tetor, 2005.
44. Software: WHAMO;
45. Software: Epanet.

11. BIOGRAFIA E KANDIDATIT

❖ INFORMACIONI BAZIK:

Emri dhe mbiemri: Gjeloš VATAJ
Data dhe vendi i lindjes: 28.03.1969, Pejë
Adresa e përhershme: Dardani SU 2/4 Nr. 40,
Prishtinë, Kosovë

❖ EDUKIMI:

1976/77-1984/85 Shkolla Fillore Komuna e Pejës , Kosovë
1985/86-1988/89 Shkolla e Mesme - Gjimnazi “QAMO 11 Maji”, Pejë, Kosovë,
1989/90-1994/95 Diplomuar në Inxhinieri Mekanike në Departamentin e Mekanikës-
Termoteknikë, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i
Tiranës, Shqipëri,
2019/20-prezent Vazhdoi studimet ne Shkolla e Doktoratës ne Inxhinieri Mekanike ne
Orientimin “Sistemet e Energjisë dhe Proceset Termike” ne Universitetin
Politeknik te Tiranës.

❖ PËRVOJA E PUNËS:

1995 - 1998 - *Projektues dhe mbikëqyrës i projekteve.* “Ndërtim-Elektro” Sh.p.k- Tiranë,
Shqipëri,
2000 – 2001 *Drejtor i Mirëmbajtjes Elektro-Makinerike.* FPU “Enërgoinvest”- Zona
Industriale- Prishtinë, Kosovë,
2002 – 2004 *Udhëheqës i Mirëmbajtjes Makinerike dhe Objekteve ne Qytet.*- Kompania
Ujësjiellësi Rajonal “PRISHTINA”, Kosovë,
2004 – 2007 *Drejtor i Prodhimit dhe Mirëmbajtjes Elektro - Makinerike.*- Kompania
Ujësjiellësi Rajonal “PRISHTINA” Kosovë,
2007 – 2011 *Menaxher Ekzekutiv i Prodhimit te Ujit.*- Kompania Ujësjiellësi Rajonal
“PRISHTINA” Kosovë,
2006 – prezent, *Bashkëpunëtor ne projekte te ndryshme*- N.SH. Instituti Tekniko
Teknologjikë ”ITEK”, Prishtine, Kosovë,
2009 – 2010 *Senior Expert-Mekanikes, Engineer* - COWI SNS Company – Danimarkë,
2011 – 2016 *Kryeshef Ekzekutiv* - Kompania Ujësjiellësi Rajonal “PRISHTINA” Kosovë,
2011 – 2015 *Anëtar i Bordit të Drejtorëve-Bordit Mbikëqyrës* - NHE “IBËR LEPENCI”,

- 2014 – 2015 Asistent i angazhuar- Mësimdhënës i lëndëve: Vizatim Teknik me Gjeometri Deskriptive dhe CAD I. Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara, Ferizaj,**
- 2015 – 2016 Asistent i angazhuar- Mësimdhënës i lëndëve: Vizatim Teknik me Gjeometri Deskriptive dhe CAD I. Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara, Ferizaj,**
- 2016 – 2017 Mësimdhënës i angazhuar- Mësimdhënës i lëndëve: Vizatim Teknik me Gjeometri Deskriptive dhe CAD I, CAD II, CAD-CAM- Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara, Ferizaj, Kosovë.**
- 2016 – 2017 Inxhinier kryesor për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri. AlbKos Internacional Company, Fushë Kosovë,**
- 2017 – prezent, Mësimdhënës i angazhuar- Mësimdhënës i lëndëve: Vizatim Teknik me Gjeometri Deskriptive dhe CAD I, CAD II, CAD-CAM- Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara, Ferizaj, Kosovë.**
- 2017 - 2018 Konsulent lokal për hartimin e projektit “Feasibility study for Waste Water Treatment (WWT) in Zubin Potok, Kosovë. Czech Development Agency, Ambasada Ceke,**
- 2018 - prezent, Mësimdhënës i Angazhuar për disa lëndë, Kolegji i Shkencave te Aplikuara Teknike “TEMPULLI”-SHPK,**
- 2017 Nëntor - Maj 2020- Anëtar i Bordit të Drejtorëve-Bordit Mbikëqyrës, Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.**

❖ *TRAJNIMET GJATË PERIUDHES 2002 – 2019:*

- **“Operimet me pajisjet Elektro-Makinerike”** Organizuar nga VATECH dhe WABAG me 08.09.2002, Prishtinë,
- Trajnim rreth **Mirëmbajtjes se pompave centrifugale te WEIR – Pumps** në Glasgow-Skoci , 18-26 Maj 2003
- **“Vizitë studiuëse në Bristol Water - Angli”** organizuar nga Kosovo Water Utilities Joint Venture (KWUJV) me 01-06 Qershor 2003, Angli ne fushat:
 - Strategjia e trajnimit te Menaxhimit - 2003,
 - Studimi për analizën e Motivimit- 2003,
- **“Furnizimi me Ujë – Problemet dhe Vështirësitë, Mbrojtja dhe Siguria në Punë dhe Analiza e Proceseve të Pompimit dhe Trajtimit, Sfidat dhe Rekomandimet”** organizuar nga Kosovë Water Utilities Joint Venture (KWUJV) dhe Bristol Water

Services (BWS) me **14-17 Korrik 2003** në Kompaninë Ujësjiellësi Rajonal “PRISHTINA” në Prishtinë,

- **“Plani i Mirëmbajtjes Elektro-Makinerike”** organizuar nga ekspertë e Bristol Water me Dhjetor 2003 në **KUR “PRISHTINA”**, Prishtinë,
- **“Ruajtja dhe shfrytëzimi i Energjisë”** Organizuar nga ekspertë e Bristol Water me 3-5 Nëntor 2003 në Kompaninë Ujësjiellësi Rajonal “PRISHTINA” në Prishtinë,
- Vizitë studimore me projektin e ZURRUM-it ne Angli dhe Vels

-Forcimi i menaxhimit te ndërmarrjeve publike dhe roli i Zyrës Rregullative ne këtë menaxhim te Ndërmarrjeve Publike,

- Vizitë studimore me projektin e SHUKOS-it ne Korenë e Jugut

-Forcimi i menaxhimit te ndërmarrjeve publike ,

- **Modern and Sustainable Water and Energy Management** in USA 2015-tre jave Gusht -21 Gusht.

Bibliografia e kandidatit

GJELOSH VATAJ

Bibliografi personale për periudhën 2002 – 2020

ARTIKUJ DHE KONTRIBUTET TE TJERA

❖ Publikimet shkencore

- [1] Fejzullahu Xhemajl, Lajqi Shpëtim, Zhitia, Ilir, **Vataj Gjelosh**. Analiza e dukurisë së kavitacionit në stacionin e pompave në Batllavë. *Revistë profesionale dhe shkencore*, 2003, Ferizaj, Kosovë,
- [2] Çausht Bajrush. **Vataj Gjelosh**, Lajqi Shpëtim. “Monografi e Kompanisë se Ujësjetllësit "PRISHTINA", Gusht 2006 Prishtinë,
- [3] Lajqi Naser, **Vataj Gjelosh**, Lajqi Shpëtim, Avdiu Arben. The influence of Cavitation's Phenomen and Water Hammer in Pumping Station of Mitrovica, <http://alpa.maliit.eu/journal/aktet/vol/?l=en>,
- [4] Lajqi Naser, **Vataj Gjelosh**, Lajqi Shpëtim, Avdiu Arben. Ndikimi i N.P.S.H. dhe grushtit hidraulik në stacionin e pompave në Mitrovicë. *Takimi i Pestë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca*, 2010, Tiranë, Shqipëri. Faqe: 463,
- [5] **Vataj Gjelosh**. Collaboration of Water Utilities with Municipal Institutions, Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Vjetore, *Proceedings Book*, 6-8 November 2013, Prishtina, Kosova
<file:///C:/Users/Gjelosh%20Vataj/OneDrive/Desktop/Proceedings-Book-2013.pdf>,
- [6] Xhevat Berisha, Korab Krasniqi, **Gjelosh Vataj**. Analysis with numerical methods of transient fluid flow with changing spatial and time steps in the simple pipeline system, *International Journal of Civil Engineering and Technology (IJCET) Publication Indexed*, <http://www.iaeme.com/ijciet/issues.asp?>,
- [7] **Gjelosh Vataj**, Xhevat Berisha. Modeling of transient fluid flow in the simple pipeline System, Asian Research Publishing Network (ARPN), Journal of Engineering and Applied Sciences 2018, http://www.arpnjournals.org/jeas/research_papers/rp_2018/jeas_0718_7183.pdf
- [8] Gjelosh Vataj, Zenel Sejfiqaj. Possibilities for increasing energy efficiency at public water sector, *EJERS-European Journal of Engineering Research and Science*,
<https://www.ejers.org/index.php/ejers/authorDashboard/submission/1762>
- [9] **Gjelosh Vataj**, Xhevat Berisha, “The Influence of Cavitations Phenomenon and Water Hammer in Batlava Pumping Station”, *International Journal of Innovative Technology and Interdisciplinary Sciences*, <http://www.ijitis.org/index.php/ijitis/article/view/71/50>

[10] **Gjelosh Vataj**, Xhevat Berisha, Zenel Sejfiqaj, “Hydraulic Modeling of Operating Modes in the Mihaliq Main Pipe-Water Treatment Plant”, International Journal of Innovative Technology and Interdisciplinary Sciences, <http://www.ijitis.org/index.php/ijitis/article/view/72/51>

Kontributi publik ne konferenca shkencore

- [11] **Gjelosh Vataj**, Shpetim Lajqi, Tush Marku. Energy efficiency for Drinking Water System. Study Case: Pumping Station in Mihaliq, *1st International Conference “Engineering and Entrepreneurship” Proceedings*, Tirana, Albania, 17-18 November 2017,
- [12] **Vataj Gjelosh**, “Plani i furnizimit me ujë për situatë emergjente, si pasojë e ndryshimit të klimës për zonën e shërbimit të KUR "Prishtina": *Konferencë dhe ekspozite e Shoqatës së Ujësjetës dhe Kanalizimeve* Prishtina 01.03.2014,
- [13] **Vataj Gjelosh**. Bashkëpunimi i Ujësjetësve me Institucionet Komunale, *Konferenca dhe ekspozita e parë vjetore “Viti i bashkëpunimit për Ujin”*, 6-8 Nëntor **2013**, Prishtine, Kosovë,
- [14] **Vataj Gjelosh**. Relacionet me publikun si instrument për ngritjen e shkallës së arkëtimit, *Konferencë dhe ekspozite e Shoqatës së Ujësjetës dhe Kanalizimeve të Shqipërisë*, Nëntor 2011, Prishtinë, Kosovë,
- [15] Lajqi Naser, **Vataj Gjelosh**, Lajqi Shpetim, Avdiu Arben. Ndikimi i N.P.S.H. dhe grushtit hidraulik në stacionin e pompave në Mitrovicë. *Takimi i Pestë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca*. 2010, Tiranë, Shqipëri. Faqe: 463,
- [16] **Gjelosh Vataj**, Zenel Sejfiqaj, Shpetim Lajqi. Possibilities for increasing energy efficiency at public water sector, *Yildiz technical university, beşiktaş campus, auditorium December 17, 2019*, [file:///C:/Users/Gjelosh%20Vataj/Downloads/Schedule%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/Gjelosh%20Vataj/Downloads/Schedule%20(1).pdf),
- [17] **Gjelosh Vataj**, Ways to reduce costs energy at the Regional Water Company “PRISHTINA”, *Conference “HIGH TECHNOLOGIES. BUSINESS. SOCIETY 2020”*, <http://www.hightechsociety.eu/>,
- [18] **Vataj Gjelosh**, Operimet me pajisjet elektro-makinerisë, *VATECH dhe WABAG*, 09.08 2002, Prishtinë,
- [19] **Vataj Gjelosh**, Zgjerimi i Operimeve Efikase në KUR “PRISHTINA”, *Konferencë dhe ekspozite e IWA dhe SHUKALB*, Maj 2013, Tiranë, Shqipëri.

Tema e Diplomës

- [20] **Vataj Gjelosh**. “Studimi i rikonstruksionit të impiantit të gjeneratorit të avullit për kalimin nga lënda djegëse ngurtë në të lëngët”.

❖ **Dokumentacioni i projektit (studimi i fizibilitetit, dizajni paraprak, dizajni i detajuar)**

Deri tani kam marrë pjesë në punën e 37-të profesionale të tilla si analiza në fushën e pompave për furnizim me ujë, bazat e asfaltit, bazat e shkëmbinjve, bazat për rërë të veçantë, bazën për beton, certifikatën e vinçit dhe ashensorit, Studim gjeomekanik dhe hidraulik për kalimin alternativ të kanalit të kthimit të granulacionit të shlakës etj.

Disa nga projektet më të rëndësishme janë përshkruar më poshtë:

- [1] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikët për Bazën e Asfaltit, të kompanisë "**GRANITI**" Istog, 2005,
- [2] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Bazën e betonit, të kompanisë "**GRANITI**" Istog, 2005,
- [3] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyeset e kompanisë "**GRANITI**" Istog, 2005,
- [4] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Bazën e betonit të kompanisë "**BENITA COMPANY**", Klinë, 2005,
- [5] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për seperacionin e kompanisë "**BENITA COMPANY**", Klinë, 2005,
- [6] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko – Teknologjikë për Gurëthyesin e kompanisë "**BENITA COMPANY**", Klinë, 2005,
- [7] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyesen mobile, të kompanisë "**I. SEFERI**" , Suharekë, 2006,
- [8] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Bazën e betonit nr. 1, të kompanisë "**I. SEFERI**", Suharekë, 2006,
- [9] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Bazën e betonit nr. 2, të kompanisë "**I. SEFERI**", Suharekë, 2006,
- [10] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Bazën e betonit të kompanisë "**ARS Beton**", Qaglavicë – Prishtinë, 2006,
- [11] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyesin e kompanisë "**BIRAQ**" , Suharekë, 2006,
- [12] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyesin e kompanisë "**BENITA COMPANY**", Klinë, 2005,
- [13] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyesin e kompanisë "**DESTANI**" sh.p.k , Fsh. Peqan, K.K. Suharekë, 2007,

- [14] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Seperacionin e kompanisë "**QENDRIMI**" sh.p.k., Fsh. Kramovik, K.K. Rahovec, 2007,
- [15] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Seperacionin e kompanisë "**GIPA**" sh.p.k., Fsh. Kramovik, K.K. Rahovec, 2007,
- [16] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Seperacionin e kompanisë "**VËLLEZERIT GJINI**" sh.p.k., Fsh. Doblibare, K.K. Gjakovë, 2007,
- [17] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Seperacionin e kompanisë "**CONDOR**" N.T.P., Kramovik, K.K. Rahovec, 2007,
- [18] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Seperacionin e kompanisë "**MENDI P**" sh.p.k., Fsh. Kramovik, K.K. Rahovec, 2007,
- [19] **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti detal "**Dizajnimi detal i stacionit te pompave në Vushtrri**" për Kompaninë Ujësjiellësit Rajonal "**MITROVICA**" sh.p.k., K.K. Mitrovicë, 2008,
- [20] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi,: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyesin & Seperacionin mobil te kompanisë "**Mercury Company**" sh.p.k. ne fsh. Baks K.K. Skenderaj, 2009,
- [21] M. Bajraktari, N. Lajqi, **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi: Projekti Tekniko - Teknologjikë për Gurëthyesin & Seperacionin mobil te kompanisë "**Alko - Impex - General Construction**" sh.p.k. ne fsh. Dabishevc K.K. Prishtinë, 2009,
- [22] BAJRAKTARI, Musli, VATAJ, GjeloSh, LAJQI, Naser, LAJQI, Shpëtim. Kontrollimi dhe certifikimi i pajisjeve të ndryshme ngritëse në servisinë e automjeteve në bazën e KFOR-it **Head Quarter Base KFOR, City Film, Prishtine**, etj.
- [23] **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi, projekti detal "**Dizajni detal i zgjerimit të fabrikës së ujit në Mitrovicë**" në kompaninë "**MITROVICA**" sh.p.k., K.K. Mitrovicë, 2010,
- [24] **Gj. Vataj**, Sh. Lajqi,: Projekti detal "**Studimi gjeomekanik & hidraulik për rrugën alternative të kanalit kthyes së granulatit të skories**" në kompaninë "**NewCo FeroNickel L.L.C.**" sh.p.k., K.K. Drenas, 2010, etj.

❖ **Mbikëqyrjet e projekteve te mëdha:**

Shteti	Data (viti)	Vlera përafërt (€)	Emri I Projektit	Pozicioni
Shqipëri	1996	70.000	<i>Projektimi i ngrohjes qendrore për ndërtesën 6 katërshe ne Tiranë.</i>	<i>Projektues</i>
Kosovë	2002	2.000.000	<i>Rehabilitimi i Objekteve te Ujës-jellësit Batllava- KUR “Prishtina”</i>	<i>Mbikëqyrës</i>
Kosovë	2003	1.500.000	<i>Rehabilitimi i Stacionit te Pompave në Batllavë-KUR “Prishtina”</i>	<i>Mbikëqyrës</i>
Kosovë	2007	100.000	<i>Rehabilitimi i Kullës ne Liqenin e Batllavës - KUR “Prishtina”</i>	<i>Mbikëqyrës</i>
Kosovë	2008	55.000	<i>Projektimi dhe Realizimi i sistemit te Ujit dhe Kanalizimit ne Konviktin e Motrave te Shën Kryqit –Prishtinë</i>	<i>Projektues dhe Mbikëqyrës</i>
Kosovë	2009/10	700.000	<i>Projektimi i Fabrikës se Ujit Mitrovicë-Cowi, Danimake</i>	<i>Projektues i pjesës mekanike</i>
Kosovë	2011/12	8.000.000	<i>Faza e Parë me Bankën Gjermane-KfW, Ndërrimi i rrjetit dhe pune tjera ne KUR “Prishtina”</i>	<i>Përgjegjësi kryesor dhe koordinator me KfW-Poz. Kryeshef Ekzekutiv</i>
Kosovë	2011/12	11.000.000	<i>Faza e Dytë me Bankën Gjermane-KfW, Ndërrimi i rrjetit dhe ndërtimi i galerisë se filtrave ne FPU BADOÇ ne KUR “Prishtina”</i>	<i>Përgjegjësi kryesor dhe koordinator me KfW-Poz. Kryeshef Ekzekutiv</i>
Kosovë	2012/16	35.000.000	<i>Faza e trete me Bankën Gjermane-KfW, Ndërtimi i Fabrikës se ujit ne SHKABAJ ne KUR “Prishtina”</i>	<i>Përgjegjësi kryesor dhe koordinator me KfW-Poz. Kryeshef Ekzekutiv</i>

12. SHTOJCAT NE CD